



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.62

2005

9 gusht

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.4641 datë 29.7.2005	Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune në komunën Buçimas, qarku Korçë.....	2251
Vendim i KM nr.535, datë 19.7.2005	Për një ndryshim në vendimin nr.270, datë 7.5.2004 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Komitetit Shtetëror të Minoriteteve të disa mjediseve, për ushtrimin e veprimtarisë së këtij Komiteti.....	2251
Vendim i KM nr.539, datë 27.7.2005	Për miratimin e protokollit të sesionit të 9-të të Komitetit të Përbashkët Ndërqeveritar Shqiptaro-Grek, për bashkëpunimin ekonomik, industrial dhe tekniko-shkencor.....	2252
Vendim i KM nr.540, datë 27.7.2005	Për miratimin e protokollit të sesionit të tretë, të Komisionit të Përbashkët Shqiptaro-Austriak, për bashkëpunimin ekonomik.....	2263
Vendim i KM nr.541, datë 27.7.2005	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Shelegar, në qytetin e Sarandës.....	2269

Vendim i KM nr.542, datë 27.7. 2005	Për miratimin e statutit të shërbimit social shtetëror	2269
Vendim i KM nr.543, datë 27.7.2005	Për kuotat kryesore të pranimit të studentëve në Universitetin Ushtarak “Skënderbej” dhe të kursantëve pasuniversitarë, për vitin akademik 2005-2006.....	2274
Vendim i KM nr.546, datë 3.8.2005	Për hapjen e shkollës së lartë universitare publike “Universiteti i Fierit”.....	2274
Vendim i KM nr.547, datë 3.8.2005	Për hapjen e shkollës së lartë universitare publike “Universiteti i Beratit”.....	2275
Vendim i KM nr.548, datë 3.8.2005	Për hapjen e shkollës së lartë universitare publike “Universiteti i Durrësit”.....	2276
Vendim i Këshillit Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë nr.68, datë 28.7.2005	Për miratimin e rregullores “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”.....	2276
Urdhër i ILDKP nr.13, datë 25.7.2005	Për një ndryshim në urdhrin nr.5/1, datë 10.5.2004 të Inspektorit të Përgjithshëm “Për miratimin e fletës së kontrollit aritmetik dhe logjik të deklaratës së pasurisë dhe detyrimeve financiare”.....	2281
Vendim i ERE nr.33, datë 21.7.2005	Për miratimin e kontratës ndërmjet OST sh.a. dhe “Darfo Albania” sh.p.k. “Për transmetimin e energjisë elektrike”.....	2283
Vendim i ERE nr.34, datë 22.7. 2005	Për dhënien e licencës për aktivitetin e importit të energjisë elektrike shoqërisë “Darfo Albania” sh.p.k.....	2284
Vendim i ERE nr.35, datë 22.7. 2005	Për dhënien e licencës të furnizuesit të kualifikuar shoqërisë “Darfo Albania” sh.p.k., për furnizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike për klientin e kualifikuar “Darfo Albania” sh.p.k.....	2284
Vendim i ERE nr.36.datë 1.8.2005	Mbi kërkesën e shoqërisë Kurum Energy sh.a. për licencën e furnizuesit të kualifikuar dhe importit të energjisë elektrike.....	2285
	Shpallje kërkesë për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “Tokë bujqësore arë”, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 Kv Sukth-Sallmonë, Durrës”.....	2285
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Demir Biduli.....	2286

DEKRET
Nr. 4641, datë 29.7.2005

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR KOMUNE
NË KOMUNËN BUÇIMAS, QARKU KORÇË**

Në mbështetje të nenit 92 germa “gj” të Kushtetutës, si dhe të nenit 14, pika 4 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet e pjeshme për kryetar komune në komunën Buçimas, qarku Korçë, të zhvillohen ditën e dielë, datë 28 gusht 2005.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr. 535, datë 19.7.2005

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.270, DATË 7.5.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË KOMITETIT
SHTETËROR TË MINORITETEVE TË DISA MJEDISEVE, PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË SË KËTIJ KOMITETI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.270, datë 7.5.2004 të Këshillit të Ministrave, fjalët “Tre apartamentet...” të bëhen “Dy apartamentet...”, ndërsa fjalët “...apartamenti nr.9, 2+1, me sipërfaqe 65.9 m², shkalla I,...” shfuqizohen.

2. Apartamenti i përmendur në pikën 1 të këtij vendimi të mbetet në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve të Trupit Diplomantik, në varësi të Ministrit të Punëve të Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 539, datë 27.7.2005

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË SESIONIT TË 9-TË TË KOMITETIT TË
PËRBASHKËT NDËRQEVERITAR SHQIPTARO-GREK, PËR BASHKËPUNIMIN
EKONOMIK, INDUSTRIAL DHE TEKNIKO-SHKENCOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të sesionit të 9-të të Komitetit të Përbashkët ndërqeveritar shqiptaro-grek, për bashkëpunimin ekonomik, industrial dhe tekniko-shkencor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PROTOKOLLI

**I SESIONIT TË 9-TË TË KOMITETIT TË PËRBASHKËT NDËRQEVERITAR SHQIPTARO-
GREK PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK, INDUSTRIAL DHE TEKNIKO-SHKENCOR**

Sesioni i 9-të i Komitetit të Përbashkët ndërqeveritar shqiptaro-grek për bashkëpunimin ekonomik, industrial dhe tekniko-shkencor, zhvilloi punimet në datat 28-29 mars 2005 në Janinë.

Delegacioni grek u drejtua nga SHTZ Evripidis Stylianidis, zëvendësministër i Punëve të Jashtme të Republikës Greke.

Delegacioni shqiptar u kryesua nga SHTZ Anastas Angjeli, Ministër i Ekonomisë i Republikës së Shqipërisë.

Përbërjet e dy delegacioneve janë shënuar në shtojcën I të këtij protokollit.

Sesioni i nëntë i Komitetit e miratoi axhendën në aneksin II të këtij protokollit.

Të dyja palët nënvizuan rëndësinë e takimeve të nivelit të lartë për zhvillimin e një klime pozitive në bashkëpunimin ekonomik ndërmjet dy vendeve. Në këtë kontekst, vizita më parë e këtij muaji e Kryeministrit shqiptar z.Fatos Nano në Greqi, si dhe takimi që u zhvillua dje këtu në Janinë, ndërmjet presidentëve, Moisiu dhe z.Papulias, kontribuan për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike ndërmjet dy vendeve.

Punimet e sesionit të nëntë të Komitetit të Përbashkët u zhvilluan në një atmosferë të përzemërt dhe miqësore, tradicionale për marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Greke. Të dyja palët theksuan edhe një herë, vullnetin e përbashkët për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve.

1. Shqyrtimi i marrëdhënieve ekonomiko-tregtare midis Greqisë dhe Shqipërisë

Të dyja palët shkëmbyen informacione rreth gjendjes ekonomike respektivisht të të dy vendeve dhe rreth mundësive ekzistuese për rritjen e bashkëpunimit ekonomik dypalësh dhe shumëpalësh.

Të dyja palët ranë dakord për rëndësinë e zhvillimit të kontakteve dhe vizitave reciproke ndërmjet përfaqësuesve të sektorit privat ose publik të vendeve përkatëse, si dhe për rëndësinë e zgjerimit të bashkëpunimit në të gjitha nivelet.

Greçia është partner i parë në shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me vendet e Ballkanit dhe zë vendin e dytë në shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me të gjitha vendet e tjera. Volumi tregtar ndërmjet dy vendeve ka ardhur në rritje dhe për vitin 2004 (i pritshmi) është më tepër se 400 milionë dollarë, nga të cilat rreth 57 milionë dollarë, janë eksporte shqiptarë në Greçi.

Të dyja palët ranë dakord se volumi i tregtisë, megjithëse në rritje, ende nuk përfaqëson potencialin e vërtetë të ekonomive të të dy vendeve. Në këtë kontekst, të dyja palët ranë dakord për të nxitur më tej kontaktet dypalëshe, me qëllim arritjen e rezultateve pozitive në zgjerimin e aktivitetit tregtar.

Pala shqiptare shprehu dëshirën e saj për nënshkrimin e një protokollit bashkëpunimi ndërmjet organizatave të nxitjes së eksporteve të të dy vendeve. Pala shqiptare i dorëzoi palës greke një draftprotokoll. Pala greke informoi që do ta shqyrtojë propozimin e mësipërm.

Të dyja palët shprehën interes lidhur me zhvillimin dhe diversifikimin e tregtisë dypalëshe duke marrë në konsideratë rolin në rritje të sektorit privat, si dhe theksuan rëndësinë e bashkëpunimit në fusha të ndryshme të ekonomisë.

Gjithashtu, të dyja palët ranë dakord për thellimin e bashkëpunimit dypalësh nëpërmjet kontakteve të shpeshta ndërmjet institucioneve, si Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, organizimi i forumeve të përbashkëta të biznesit, pjesëmarrja në panairë dhe ekspozita për vendosjen dhe rritjen e kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet biznesmenëve, sikurse dhe një partneritet më i ngushtë ndërmjet dy vendeve në fushën e tregtisë.

2. Rritja e bashkëpunimit dypalësh ekonomik dhe identifikimi i prioriteve sipas sektorëve

2.1 Energjia

Gazi dhe nafta

Të dyja palët shprehën dëshirën e tyre për shqyrtimin e mundësive për të bashkëpunuar në zhvillimin e projektit rajonal lindje- perëndim të gazsjellësit, duke marrë në konsideratë avantazhet që ofrohen nga kalimi i tij përmes territorit shqiptar.

Në kuadër të intensifikimit të bashkëpunimit mes instituteve kërkimore të të dy vendeve, të dyja palët vlerësojnë forcimin e bashkëpunimit në fushat rajonale, gjeologjike dhe naftëmbajtëse.

Në fushën e privatizimit, pala shqiptare ftoi kompanitë greke të marrin pjesë në privatizimin e kompanive shtetërore të naftës.

Me qëllim rritjen e bashkëpunimit në të ardhmen në këtë fushë, pala shqiptare propozoi:

- Kryerjen e studimeve të përbashkëta gjeologjike për eksplorimin e burimeve naftëmbajtëse në rajonet kufitare;

- Marrjen e përvijës nga pala greke për përmirësimin e legjislacionit, standardeve dhe kontrollit në fushën e hidrokarboneve;

- Bashkëpunim në kuadrin e projekteve të Bashkimit Europian.

Energjia

Pala greke përmendi që Korporata Greke e Energjisë Publike është e interesuar të marrë pjesë në procedurat e ardhshme të privatizimit të Kompanisë së Integruar Elektrike Shqiptare KESH.

Korporata Greke e Energjisë Publike ka mundësi të ofrojë shërbime trajnimi dhe konsulence ndaj Kompanisë së Integruar Elektrike Shqiptare KESH në sektorët e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë.

Qendra e Standardeve dhe Kërkimore e Provave të Korporatës së Energjisë Publike, e cila përgjigjet kryesisht për kontrollin e cilësisë në Korporatën e Energjisë Publike, mund të ofrojë shërbime testimi, ekzaminimi dhe analizimi të materialeve, makineri, pajisje dhe materiale përdorimi në emër të çdo kompanie të interesuar (p.sh. KESH).

Sistemet e energjisë elektrike greke dhe shqiptare punojnë paralelisht prej shumë vitesh në kuadër të rrjetit të ndërlidhur të UKTE (Unioni i Koordinimit të Transmetimit të Energjisë Elektrike).

Duke marrë parasysh rëndësinë e furnizimit me energji dhe sigurinë për Greqinë, Shqipërinë dhe të gjithë rajonin, rekomandohet:

- Operatori Shqiptar i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori Grek i Sistemit të Transmetimit të bëjnë përpjekje për një shfrytëzim më të mirë të LTL 400 Kv Elbasan-Kardia në favor të sistemeve elektrike të të dy vendeve.

- LTL 400 Kv Elbasan-Podgoricë të ndërtohet si një projekt të përparësisë më të lartë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Me qëllim rritjen e bashkëpunimit në këtë fushë, pala shqiptare propozoi:

- Krijimin e një nënkomisioni për përdorimin e përbashkët optimal të potencialit hidro elektrik nëpërmjet përdorimit të ujërave të lumit Vjosë;

- Zhvillimin e takimeve në nivel ekspertësh për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet korporatave energjitike të të dy vendeve;

- Realizimin e projekteve në zonat kufitare.

Energjia ripërtëritëse

Në kuadrin e bashkëpunimit të Qendrës për Burimet e Energjisë Ripërtëritëse (CRES) me organizatat shqiptare përkatëse, pala greke propozoi dhe pala shqiptare ra dakord për sa më poshtë:

1. Zhvillimin e një bashkëpunimi të frytshëm për burimet e energjisë ripërtëritëse (BER), përdorimin racional të energjisë (PRE), kursimin e energjisë (KE), në sektorët e kërkimit, mbështetjes teknike, propagandimit dhe informacionit.

2. Bashkëpunimin me organizatat shqiptare të energjisë dhe mbështetjen e aktiviteteve të Agjencisë Kombëtare të Energjisë.

3. Zhvillimin e ndërgjegjësimit publik dhe programeve informuese rreth burimeve të energjisë ripërtëritëse, si dhe programe të edukimit dhe trajnimit të ekspertëve dhe teknikëve rreth çështjeve përkatëse.

4. Krijimin dhe funksionimin e projekteve pilot dhe demonstruese:

- përdorimi i energjisë diellore (sistemi diellor termal për prodhimin e ujit të ngrohtë ose sistemet fotovoltike për prodhimin e energjisë elektrike);

- shfrytëzimi i potencialit të vogël hidroelektrik të vendit, nëpërmjet rivënies në punë të stacioneve të vjetra dhe instalimit të stacioneve të reja.

5. Zbatimin e sistemeve efçente të energjisë dhe arkitekturës bioklimatike në ndërtesat publike ose/dhe private.

6. Zbatimin e studimeve të impaktit të mjedisit mbi aplikimet e BER, PRE dhe KE .

2.2 Telekomunikacionet

Të dyja palët ranë dakord mbi:

1. Vazhdimin e bashkëpunimit pozitiv ndërmjet dy vendeve me qëllim që të arrijnë procesin e koordinimit të frekuencave analoge të stacioneve televizive në kuadrin e rishikimit të Marrëveshjes së Stokholmit të vitit 1961 dhe të vazhdojnë me formulimin e planit dixhital të frekuencave.

2. Bashkëpunimin e mirë të dy vendeve në kuadër të rregullave të ITU, për nxitjen e koordinimit ndërkuftar të rrjeteve të gjenerimit të tretë të telefonisë celulare. Në këtë aspekt, të dyja palët do të takohen me qëllim nënshkrimit të marrëveshjes përkatëse.

3. Pala shqiptare shprehu dëshirën e saj për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet rrjetit të telekomunikacionit të Albtelecom sh.a. dhe Rrjetit Grek të Telekomunikacionit të OTE nëpërmjet përmirësimit të transmetimit me fibra optike nëndetare, Shqipëri (Durrës) – Greqi (Korfuz), që synojnë përmirësimin e komunikimit ndërmjet dy vendeve, si dhe ofrimin e kapaciteteve ndaj operatorëve të tjerë të telekomunikacionit.

Pala greke shprehu dëshirën për përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet OTE Globe dhe Albtelecom, duke i dhënë palës përkatëse shqiptare shërbime lidhëse telekomunikacioni të besueshme dhe konkurruese mbi rrjetin e ri OTE nga Greqia në Europën Perëndimore (GWEN).

Të dyja palët shprehën vullnetin e tyre për të rregulluar ndryshimet ekonomike aktuale ndërmjet AMC, ALBTELECOM dhe OTE, duke marrë parasysh liberalizimin e tregut shqiptar të telekomunikacioneve, për një zhvillim të qëndrueshëm të telekomunikacionit mobil, përfshirë edhe LMDS.

Të dyja palët ranë dakord mbi zhvillimin e diskutimeve të mëtejshme ndërmjet palëve të interesuara.

Të dyja palët shprehën vullnetin e tyre për të shqyrtuar dhe forcuar më tej bashkëpunimin ekzistues në fusha të ndryshme ndërmjet organizatave përkatëse publike të transmetimit.

Zgjerimi i këtij bashkëpunimi mund të përfshijë shkëmbimin e programeve të radios dhe të televizionit, organizimin e seminareve të trajnimit, pjesëmarrjen në tregje dhe festivale televizive të organizuara në të dy vendet, shkëmbim të informacionit dhe të të dhënave teknike, organizimin e vizitave në nivele të ndryshme për azhurnime reciproke.

Pala greke kërkoi që programi ERT-SAT të transmetohet në mënyrë të përshtatshme në Tiranë.

Pala shqiptare mori shënim kërkesën greke dhe mori përsipër detyrimin për transmetimin e saj tek autoritetet përkatëse shqiptare.

2.3 Posta

Me qëllim mundësimin e shërbimeve postare të të dy vendeve për të luajtur një rol parësor në zhvillimin e shkëmbimeve tregtare ndërmjet dy vendeve dhe më gjerë, posta Greke - ELTA është e interesuar në zhvillimin e një bashkëpunimi tregtar me Administratën e Postave të Shqipërisë, veçanërisht në fushat e shërbimeve postare, shërbimeve korriere dhe postave ndërkombëtare, si edhe shërbimeve me vlera të shtuara (ekspres, e siguruar, artikuj me shpërndarje të regjistruar etj.).

Në këtë kuadër, të dyja palët ranë dakord që të shqyrtojnë mënyrat për:

- zhvillimin e produkteve (p.sh. të pakove postare, shërbimeve korriere etj.) në një bazë dypalëshe, duke marrë në konsideratë kushtet e tregut;

- krijimin e një njësie për dorëzimin e artikujve postare ndërkombëtare;

- formulimin e një politike konkurruese çmimesh për shërbimet e sipërshtënuara, e cila duhet të zbatohet nga të dy vendet;

- shkëmbimin e ekspertizës për përmirësimin e shërbimeve të ofruara dhe zhvillimin e teknologjive, të cilat i shtojnë vlerat prodhimeve (gjetja dhe ndjekja, ndjekja elektronike, cilësia e monitorimit të shërbimit etj.);

- identifikimin e sinergjive të mundshme në sektorin e shërbimeve postare ndërkombëtare.

2.4 Administrata doganore

Të dyja palët shprehën gatishmërinë që të vazhdojnë takimet e rregullta të drejtorëve të administratave të doganave për të rritur bashkëpunimin në fushën e doganave, duke synuar zhvillimin e mëtejshëm të fluksit të tregtisë, thjeshtimin e procedurave doganore dhe luftimin e kontrabandës dhe trafikut të drogës.

Gjithashtu, të dyja palët vërejtën me kënaqësi hapjen e stacionit të ri të pikës së kalimit të kufirit në Mavromati – Qafë Bode në 1 janar 2005, e cila pritet të thjeshtojë dukshëm lëvizjen e personave dhe mallrave në prefekturën e Thesprotisë (Igumenicë) në Greqi dhe rajonit të zgjeruar të Sarandës në Shqipëri.

Të dyja palët vlerësuan se, në bazë të Marrëveshjes dypalëshe për bashkëpunim dhe ndihmë reciproke të administratave doganore ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë, e cila hyri në fuqi më 28 gusht 1994, bashkëpunimi i tyre mund të bëhet më i frytshëm duke shqyrtuar rastet më të rëndësishme për përgjigje ndaj kërkesave për asistencë administrative.

Pala shqiptare shprehu interes për lidhjen e një protokollit bashkëpunimi në planin operativ ndërmjet drejtorive homologe.

2.5 Administrata tatimore

Të dyja palët shprehën kënaqësinë e tyre të thellë lidhur me nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi më 1 janar 2001 të konventës së taksimit të dyfishtë ndërmjet Republikës së Greqisë dhe Republikës së Shqipërisë për mënjanimin e taksimit të dyfishtë në drejtim të taksave mbi të ardhurat dhe kapitalin.

Kjo konventë do t'u mundësojë të dy komuniteteve ekonomike krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe miqësor të taksave për zhvillimin e biznesit ndërmjet dy vendeve, duke lënë mënjanimë ndryshimet e mundshme të legjislativëve të tyre të brendshme.

Të dyja palët theksuan vullnetin e tyre për të forcuar më tej bashkëpunimin, si dhe synimin për të kontribuar aktivisht në zbatimin e konventës së mësipërme të taksimit të dyfishtë.

2.6 Bujqësia

Të dyja palët shqyrtuan bashkëpunimin dypalësh në fushën e bujqësisë dhe ranë dakord se ekzistojnë mundësi të konsiderueshme për forcimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi.

Pala shqiptare shprehu kënaqësinë e saj për ndihmën teknike të dhënë nga pala greke që prej vitit 1999 (seminare trajnuese dhe vizita, ndihma ushqimore, krijimin e serave, bursa për studime pasuniversitare).

Pala greke shprehu interesin e saj për të zhvilluar bashkëpunimin në sektorin e burimeve pyjore dhe për të shkëmbyer informacion në fushat e biodiversitetit, ruajtjen e specieve, faunës dhe florës, shkëmbimin e materialeve gjenetike dhe menaxhimin e pyjeve.

Të dyja palët ranë dakord gjithashtu për të shkëmbyer informacion dhe përvojë në fushën e veterinarisë, mbrojtjen e bimëve dhe prodhimin e kafshëve, në mënyrë që pala shqiptare të përfitojë nga përvoja e Greqisë.

Në përgjigje të një kërkesë nga pala shqiptare, pala greke mori përsipër të organizojë një seminar trajnues në fushën e veterinarisë, fitosanitare dhe sigurisë ushqimore për ekspertët shqiptarë, brenda gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2005. Pala greke do të mbulojë të gjitha shpenzimet (si akomodim, trajnim, transportin e brendshëm), përveç transportit ndërkombëtar.

Të dyja palët shqyrtuan projekt marrëveshjen për bashkëpunimin ekonomik, shkencor dhe teknik në fushën e bujqësisë, dorëzuar nga pala greke dhe ranë dakord të marrin të gjitha masat e nevojshme për finalizimin e saj.

Në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë në procesin e stabilizim- asocimit dhe integrimin e saj gradual në strukturat e BE-së, të dyja palët shprehën dëshirën për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet organizmave të tyre respektive dhe instituteve kërkimore nëpërmjet programit CARDS.

2.7 Mjedisi

Të dyja palët nënvizuan rëndësinë e veçantë të mbrojtjes së mjedisit dhe shprehën vullnetin për forcimin e bashkëpunimit dypalësh në këtë fushë.

Për këtë qëllim, të dyja palët nënshkruan në Athinë më 3 prill 2003 një memorandum mirëkuptimi dhe bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Lidhur me bashkëpunimin në të ardhmen, pala shqiptare propozoi aktivizimin dhe zbatimin e memorandumit të sipërpërmendur, duke krijuar një komision të përbashkët për identifikimin e projekteve dhe fushave të përbashkëta të bashkëpunimit ndërkufitar.

Pala shqiptare informoi palën greke që e ka ratifikuar memorandumun e mësipërm. Pala shqiptare do të informohet menjëherë sapo të mbarojë procesi i ratifikimit të memorandumit të mirëkuptimit nga pala greke.

Pala shqiptare shënoi aktivitetet dhe strukturat e ngritura në lidhje me krijimin e parkut të Prespës dhe u shpreh se bashkëpunimi trepalësh ndërmjet tre shteteve që lagen nga liqeni i Prespës ka ardhur në rritje përsa i përket problemeve mjedisore.

Pala shqiptare shprehu interesin e saj për dy propozime projektesh në fushën e mjedisit, të cilat i janë paraqitur paraprakisht palës greke për financim.

Pala greke do t'i shqyrtojë dy projektet e propozuara nga pala shqiptare në sektorin e mbrojtjes së mjedisit, përkatësisht mbledhja e mbeturinave dhe qendra për biotopet.

2.8 Transporti

Të dyja palët shprehën kënaqësinë për nivelin e lartë të bashkëpunimit ndërmjet ministrive të transporteve të të dy vendeve.

Me rastin e sesionit të fundit të Komitetit të Përbashkët mbi transportin rrugor, të dyja palët ranë dakord të vendosin një kuotë lejesh për transportin e mallrave dypalësh dhe transit në një total prej 36 000 lejesh, pa pagesë.

Për më tepër, të dyja palët ranë dakord që çdo problem që mund të lindë në veprimtarinë e tetë linjave të rregullta të autobusëve që ekzistojnë aktualisht, si dhe çdo kërkesë për vendosjen e linjave të rregullta shtesë, duhet shqyrtuar nëpërmjet korrespondencës midis ministrive kompetente.

Në lidhje me transportin rastësor të paliberalizuar të pasagjerëve, të dyja palët ranë dakord të shkëmbejnë një total prej 75 lelesh në vit.

Në fushën e transportit ajror, pala shqiptare propozoi si vijon:

- Rinovimin ose nënshkrimin e një marrëveshjeje të re në fushën e transportit ajror;
- Aplikimin e standardeve të liberalizuara në këtë marrëveshje për shfrytëzimin e tregut ajror midis dy vendeve;
- Rinovimin e marrëveshjes midis autoriteteve të aviacionit për procedurat e “Kontrollit të fluturimit”.

2.9 Mbrojtja civile

Pala greke është e bindur se në rastet e fatkeqësive natyrore, teknologjike dhe të tjera fatkeqësi të përmasave të mëdha, (të cilat zgjaten përtej kufijve shtetërorë), kërkohet bashkëpunim dhe veprime të pranuar të përbashkëta. Pala greke propozoi forcimin e bashkëpunimit dhe sinergjisë ndërmjet dy vendeve, në fushën e mbrojtjes civile, me anë të një marrëveshjeje dypalëshe.

Të dyja palët shprehën gatishmërinë për të nënshkruar brenda vitit 2005 një marrëveshje bashkëpunimi midis shërbimeve zjarrfikëse të të dy vendeve në fushën e trajnimit dhe logjistikës.

2.10 Punët publike, strehimi dhe zhvillimi urban

Strehimi

Të dyja palët shprehën gatishmërinë për të nxitur bashkëpunimin në projekte pilot në vende historike me pjesëmarrjen e komuniteteve, në veprime të përbashkëta të koordinuara nga bashkitë (si përmirësimin e banesave dhe mjediseve në bashkëpronësi, futjen e elementeve të kursimit të energjisë, si dhe të përdorimit të energjisë ripërtëritëse (diellore).

Rregullat Teknike

Pala shqiptare shprehu interesin e saj në:

1. Marrje përvojë nga pala greke në hartimin e rregullave teknike dhe harmonizimin e tyre me ato të BE-së.
2. Marrje ndihme për hartimin e kuadrit rregullator
3. Shkëmbim mendimesh dhe përvojash për rolin dhe përgjegjësitë e ministrive përkatëse në drejtim të zbatimit të direktivës për produktet e ndërtimit që do t'i nënshtrohen vlerësimit të konformitetit.
4. Marrje e përvojës greke mbi mënyrën si funksionojnë institucionet e specializuara për kontrollin në sektorin e punëve publike, përfshirë dhe marrëdhëniet e tyre me ministrinë.

Ujërat

Pala shqiptare parashtrroi kërkesën lidhur me ratifikimin nga pala greke të marrëveshjes “Për krijimin e një Komisioni të Përhershëm Shqiptaro-Grek për çështjet e ujërave ndërkufitare “, nënshkruar më 3 prill 2003.

Planifikimi urban

Pala shqiptare parashtrroi kërkesën për marrjen e asistencës nga pala greke lidhur me:

- Përafrimin e legjislacionit të zhvillimit urban.
- Metodologjinë e hartimit të planeve fizike dhe konkretisht në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Planifikimit Urban (ISPU) dhe njësitë e qeverisjes.

EYDAP – Korporata e Furnizimit me Ujë dhe e Ujërave të Zeza e Athinës, tregoi fushat e bashkëpunimit me palën shqiptare ku EYDAP mund të kontribuojë në:

1. Vënien në punë dhe mirëmbajtjen e ujit të pijshëm dhe stacioneve të trajtimit të ujërave të ndotura.
2. Zbulimin e çarjeve/humbjeve në rrjetet e shpërndarjes së ujit të pijshëm.
3. Monitorimin e veprimtarisë së tubave të ujërave të ndotura dhe kontrollin e erërave.
4. Menaxhimin e rrjetit hidraulik.

2.11 Shëndetësia

Të dyja palët theksuan bashkëpunimin e frytshëm në fushën e shëndetësisë, përfshirë asistencën e spitaleve greke për trajtimin e një numri pacientësh shqiptarë, si dhe në zbatimin e disa projekteve që lidhen me shëndetin publik në kuadrin e projektit INTERREG

2.12 Turizmi

Të dyja palët theksuan gatishmërinë e tyre për të zhvilluar më tej bashkëpunimin mes dy vendeve në sektorin turistik nëpërmjet bashkëpunimit të mirë të vendosur nga autoritetet përkatëse kombëtare të turizmit dhe nga zbatimi i marrëveshjes mbi bashkëpunimin në turizëm.

Pala shqiptare shprehu interes për bashkëpunim në fushat e mëposhtme:

1. Legjislacioni mbi ushtrimin e veprimtarive turistike dhe rregullimin ligjor të marrëdhënieve midis administratës shtetërore dhe subjekteve private/ publike.

2. Mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shoqatave të hotelierisë, agjencive turistike dhe udhëtimeve.

3. Shkëmbimi i përvojës në zhvillimin e zonave turistike, duke synuar zhvillimin e rezorteve turistike të infrastrukturës, si dhe investimet për turizmin.

4. Shkëmbimi i përvojës në grumbullimin dhe përpilimin e informacionit statistikor lidhur me turizmin.

2.13 Bashkëpunimi teknologjiko-shkencor

Marrëveshja greko-shqiptare mbi bashkëpunimin në fushën e shkencës dhe të teknologjisë ndërmjet Sekretariatit të Përgjithshëm të Kërkimit dhe Teknologjisë, Ministrisë së Zhvillimit, Greqi dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Shqipëri është nënshkruar më 4 dhjetor 1984 në Tiranë. Që atëherë, janë nënshkruar gjashtë (6) protokolle bashkëpunimi (1987, 1989, 1991, 2000 dhe 2003).

Së fundmi, gjatë komitetit të fundit të përbashkët që u zhvillua në Athinë në vitin 2003, u miratuan njëzet e dy (22) projekte të përbashkëta (nga një total prej 69 që u dorëzuan) me kohëzgjatje prej dy vjetësh dhe buxhet total 321 615 euro (nga pala greke) në sektorët shkencorë që vijojnë:

Trashëgimi kulturore – 5, mjedis – 3, shkenca shëndetësore – 3, energji – 2, gjeologji, gjeofizikë, sizmologji – 3, agrikulturë, veterinari dhe teknologji ushqimore – 6.

Periodha e ardhshme për propozime pritet të publikohet në gjashtëmuorin e parë të vitit 2005 dhe Komiteti i Përbashkët pritet të zhvillojë punimet në Tiranë në fund të vitit 2005, që të dyja në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme. Një workshop do të zhvillohet në Athinë përpara Komitetit të Përbashkët, gjatë të cilit shkencëtarët përgjegjës për shkencën dhe teknologjinë do të paraqesin punët e tyre.

Pala shqiptare shprehu interesin e saj për nënshkrimin e protokollit të radhës të bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik.

2.14. Bashkëpunimi në fushën e punësimit dhe dialogut social

Të dyja palët shprehen kënaqësinë për bashkëpunimin ndërmjet lëvizjeve sindikaliste të të dy vendeve dhe shkëmbimet dypalëshe të realizuara në nivel konfederal dhe federal/sectorial. Gjithashtu, lëvizjet sindikaliste përkatëse shprehën vullnetin për të zhvilluar bashkëpunimin e tyre.

Instituti grek (INE-GSEE/ADEDY) dhe akademia e sapokrijuar e sindikatës, theksuan fushat e edukimit sindikalist – mësim dhe trajnim i përhershëm për punëtorë si fusha potenciale bashkëpunimi, ndërmjet të tjerash si:

- Zhvillimi i infrastrukturave për mbështetjen e veprimtarisë së sindikatave.

- Zhvillimi i institucioneve dhe proceseve në fusha të tilla si dialogu social, partneriteti social.

- Mbështetje me materiale dhe pajisje teknike.

- Çështje lidhur me emigracionin dhe problemet e shqiptarëve që jetojnë dhe punojnë në Greqi.

OAED-ja greke, në kuadrin e thellimit të bashkëpunimit në fushën e arsimit dhe punësimit ndërmjet NES-it shqiptar dhe OAED-së, shprehu gatishmërinë:

- për të kontribuar në zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi të kompletuar të trajnimit profesional dhe punësimit në Shqipëri.

- për të dhënë asistencë teknike me qëllim sjelljen e kuadrit ligjor në punësim, punë dhe trajnim profesional, hap pas hapi, pranë Bashkimit Europian.

Të dyja palët shprehën vullnetin e tyre lidhur me:

1. Thellimin e bashkëpunimit në fushat e punësimit dhe shërbimit të mbrojtjes sociale të emigracionit.

2. Fillimin e bisedimeve paraprake për marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale të Shqipërisë dhe Ministrisë së Punës dhe Mbrojtjes Sociale të Greqisë.

3. Thellimin e bashkëpunimit në fushën e formimit profesional duke filluar fazën e dytë të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale të Shqipërisë dhe OAED-së (për rritjen e kapaciteteve institucionale të zyrave të punësimit dhe zyrave të arsimimit profesional për shqiptarët në qendrat arsimore të OAED-së).

4. Zbatimin e marrëveshjes aktuale të punësimit sezonal të nënshkruar në 1996 dhe përmirësimet e saj në përputhje me legjislacionin e ri të përgatitur në të dy vendet.

2.15 Industria dhe SME-të

Të dyja palët ranë dakord për përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit industrial, lidhur me shkëmbimin e praktikave administrative, transferimin e ekspertizës, trajnimin e personelit, mjeteve publike për mbështetjen e SME-ve dhe të tjera aktivitete reciproke të përbashkëta në sektorët më premtues industrialë si:

- Industria e letrës
- Tekstil dhe veshje, lëkurë – këpucë
- Detergjente
- Parafarmaceutikët
- Kozmetika
- Artikuj të tjerë industrialë me konsum të gjerë.

Të dyja palët shprehen dëshirën për riaktivizimin e bashkëpunimit të frytshëm të së kaluarës ndërmjet Organizatës Greke për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (EOMMEX SA) dhe Agjencisë Shqiptare të SME-ve, me qëllim përfitimin nga SME-të në të dy vendet.

Për këtë qëllim, përfaqësuesit e EOMMEX SA dhe Agjencisë Shqiptare të SME-ve do të shqyrtojnë fusha të reja të bashkëpunimit në drejtimit e përgjegjësive të tyre.

Pala shqiptare i dorëzoi palës greke një draftprotokoll bashkëpunimi ndërmjet EOMMEX dhe Agjencisë Shqiptare të SME-ve, me qëllim që t'i dorëzohet EOMMEX-it.

2.16 Gjeologjia dhe minierat

Të dyja palët ranë dakord për nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet instituteve përkatëse në kuadër të instrumenteve ekzistuese në fushat e mëposhtme:

- Industrinë nxjerrëse të mineraleve, materialeve të ndërtimit dhe gurëve dekorativë në Shqipëri.

- Shkëmbimi i përvojës në lidhje me procedurat, dokumentacionin dhe monitorimin.

- Administrimin e minierave ekzistuese dhe të mbyllura në fushën e administrimit dhe menaxhimit të kompanive private minerare dhe midis institucioneve teknike dhe shkencore.

4. Investimet greke në Shqipëri

i) Situata aktuale dhe perspektivat

Të dyja palët vunë re me kënaqësi se investimet greke në Shqipëri kanë ardhur në rritje dhe kanë kontribuar në zhvillimin e ekonomisë shqiptare në një numër të madh sektorësh.

Pala shqiptare theksoi se janë rreth 250 ndërmarrje që operojnë aktualisht në Shqipëri ndërsa kapitali grek i investuar ka një vlerë më se 385 milionë dollarë.

Të dyja palët konstatuan se ndërmarrjet greke apo të përbashkëta greko-shqiptare kanë investuar kryesisht në sektorët e bankave, telekomunikacionit, ndërtimit, kompanive të naftës, industrinë e duhanit, tekstileve, industrinë ushqimore, informatikës, si dhe gjithashtu në industrinë metalurgjike etj.

Pala shqiptare shprehu interesin për rritjen e mëtejshme të investimeve greke në Shqipëri.

Të dyja palët ranë dakord për të forcuar më shumë bashkëpunimin në shkëmbimin e informacionit në sektorët e interesit të përbashkët.

Të dyja palët u angazhuan për gjetjen e mundësive të pashfrytëzuara për nxitjen e investimeve greke në Shqipëri.

Të dyja palët ranë dakord se përmirësimi i infrastrukturës (transporti, energjia, furnizimi me ujë, bankat etj.), transparenca, stabiliteti social, siguria, si dhe zbatimi i përshtatshëm i ligjeve dhe marrëveshjeve bilaterale në lidhje me mbrojtjen e investimeve të huaja dhe mënjanimi i taksimit të dyfishtë, do të kontribuojnë në rritjen e investimeve Greke në Shqipëri.

Pala shqiptare shprehu interes lidhur me tërheqjen e investitorëve strategjikë greke në industrinë e minierave, energjisë, turizmit, bankave, shërbimeve të transportit dhe infrastrukturës. Turizmi dhe bujqësia janë dy sektorë që ofrojnë mundësi të mëdha për investime afatgjata.

Të dyja palët shprehën gatishmërinë për gjetjen e mundësive në fushën e nxitjes së investimeve mes agjencive respektive shqiptare dhe greke.

Pala shqiptare ftoi palën greke për të nxitur pjesëmarrjen e investitorëve grekë në procesin e privatizimit të projekteve të saj shtetërore dhe për të investuar në industrinë kryesore të vendit.

ii) Përmirësimi i mjedisit të biznesit

Të dyja palët ranë dakord dhe konfirmuan që mjedisi i biznesit në Shqipëri është përmirësuar dhe është duke u bërë më tërheqës për biznesin privat.

Pala greke ngriti disa shqetësime të komunitetit të biznesit grek, veçanërisht nga kompanitë e naftës, për sa i përket disa çështjeve specifike lidhur me procedurat administrative, zbatimin e legjislacionit, si dhe me çështje të barrierave administrative dhe licencimit, pronësia e tokës, të cilat janë të lidhura me veprimtarinë e departamenteve të administratës së doganave dhe taksave dhe institucioneve të tjera.

Të dyja palët ranë dakord që angazhimi për forcimin e sundimit të ligjit, duke eliminuar pengesat administrative, duke përmirësuar mjedisin e biznesit në Shqipëri dhe punën për konsolidimin e tyre e në mënyrë të veçantë për harmonizimin e legjislacionit shqiptar në përputhje me *acquis communautaire* të BE-së, është shumë i rëndësishëm.

Në përputhje me rregullat e OBT-së, organizatë në të cilën Shqipëria bën pjesë që prej vitit 2000, rregullat që aplikohen janë të njëjta për të gjitha vendet e rajonit.

Pala shqiptare e siguroi palën greke që kompanitë dhe bizneset greke janë të mirëpritura dhe inkurajohen të investojnë në Shqipëri, duke u trajtuar në mënyrë të njëjtë me kompanitë e vendeve të tjera.

Brenda kuadrit të Marrëveshjes Shengen, pala greke do të inkurajojë dhe lehtësojë hyrjen në Greqi për përfaqësuesit e kompanive të regjistruara në dhomat respektive të tregtisë apo unioneve të biznesit.

4. Bashkëpunimi ndërrajonal

Autoritetet lokale

Të dyja palët shprehën kënaqësinë e thellë për nivelin e shkëlqyer të bashkëpunimit ndërrajonal. Autoritetet lokale kanë arritur të zhvillojnë me sukses një numër të madh veprimtarish ndërkufitare në fushat e bashkëpunimit ekonomik, kujdesit shëndetësor, mjedisit, kulturës, mbrojtjes civile etj.

Pala shqiptare shprehu kënaqësinë për ndihmën e ofruar kohët e fundit nga Prefektura e Kastorias lidhur me pastrimin e rrugëve kryesore të Korçës nga bora, falë bashkëpunimit dhe marrëdhënieve të mira.

Të dyja palët shprehën dëshirën për nxitjen e mëtejshme të bashkëpunimit ndërrajonal, duke zhvilluar projekte të interesit të përbashkët, në mënyrë që të krijohet sfondi i kërkuar për zhvillimin e përbashkët ekonomik të të dy rajoneve.

Të dyja palët ranë dakord të shqyrtojnë mundësitë për thellimin e bashkëpunimit ndërkufitar në fushat e mëposhtme:

1. Zhvillimi i përshtatshëm i SME-ve dhe biznesit.
2. Bashkëpunim midis dhomave lokale të tregtisë përgjatë kufirit.
3. Trajnim dhe transferim i ekspertizës.
4. Zhvillimi i zonave bujqësore dhe bregdetare.
5. Zhvillimi i industrisë turistike dhe kulturore.
6. Mbrojtje mjedisore.

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh të dyja palët vlerësuan pozitivisht progresin e arritur deri tani në programin e bashkëpunimit për asistencë reciproke me projektin e investimit për infrastrukturën në Shqipërinë e Jugut.

Me qëllim nxitjen e bashkëpunimit në këtë fushë, pala shqiptare propozoi si më poshtë:

- Realizimin e trajnimeve dhe marrjen e eksperiencës në fushat e menaxhimit ekonomiko-financiar, zhvillimit ekonomik vendor dhe rajonal, menaxhimit të burimeve njerëzore në strukturat e qeverisjes vendore, menaxhimit të funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara dhe aspektet ligjore të reformës së decentralizimit.

- Projekte në fushën e zhvillimit social, veçanërisht në rikonstrukcionin e çerdheve për fëmijë.

- Shtirja e projektit të investimeve për infrastrukturën në Shqipërinë e Jugut edhe në njësi të tjera të qeverisjes vendore.

Bashkëpunimi në kuadër të programit INTERREG III/CARDS

Pala greke i kushton rëndësi të veçantë bashkëpunimit ndërmjet rajoneve kufitare të Greqisë dhe Shqipërisë dhe ka bërë përpjekje të mëdha për të siguruar që fondet në dispozicion të garantojnë zbatimin e suksesshëm të veprimeve të INTERREG III A Greqi – Shqipëri. Në kuadër të këtij programi, është rezervuar/hequr mënjanë një shumë totale prej 126 milionë eurosh.

Rajonet e zgjedhura që do të përfitojnë në kuadër të këtij programi janë si më poshtë:

Greqi:

- Rajoni i Maqedonisë Perëndimore (prefektura e Florinës dhe Kastorias).

- Rajoni i Epirit (Prefektura e Janinës dhe Thesprotisë).

- Rajoni i ishujve të Jonit (prefektura e Korfuzit).

Shqipëri:

- Qarku Gjirokastrë (rrethet Gjirokastrë dhe Përmet).

- Qarku Korçë (rrethet Korçë, Devoll dhe Kolonjë).

- Qarku Vlorë (rrethi Sarandë).

Gjithashtu, programi CARDS do të fokusohet në veprime specifike në fushën e transportit në bashkëpunim me BEI dhe donatorë të tjerë, me qëllim përmirësimin e akseve rrugore që lidhin Shqipërinë me Greqinë.

Në këtë kuadër, të dyja palët vlerësuan organizimin e disa takimeve dhe seminareve në kuadër të INTERREG III A Greqi – Shqipëri, si dhe zhvillimin e disa seminareve mbi çështjet e koordinimit dhe zbatimit të programit të fqinjësisë.

Sa më sipër, pala shqiptare informoi palën greke se është nënshkruar marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për “Programin vjetor të veprimit të fqinjësisë CARDS 2004” mbi programin e rishikuar të fqinjësisë Shqipëri- Greqi. Në këtë marrëveshje u konfirmua dhënia e fondeve për Shqipërinë. Shuma që është caktuar për Shqipërinë është 6.6 milionë euro për vitin 2004. Në këtë kuadër janë ngritur strukturat e përbashkëta të menaxhimit të këtij programi me qëllim për t’i paraprirë aprovimit të procedurave dhe rregullave të funksionimit të tyre. Programi i fqinjësisë për vitin 2004 Greqi -Shqipëri akordon 2.2 milion euro për projektet që do të zbatohen në Shqipëri (për qarqet Korçë, Gjirokastrë e Vlorë).

Pala shqiptare është në fazën e përgatitjes së projekteve, me qëllim paraqitjen e projekteve për vitin 2005, të cilat duhet të plotësojnë kriteret e programit duke harmonizuar procedurat e aplikuar deri tani për fondet e jashtme (CARDS) dhe fondet e brendshme (INTERREG).

Të dyja palët shprehën angazhimin e tyre për të krijuar projekte të përbashkëta dhe mbështetur miratimin e tyre, në mënyrë që ta zbatojnë këtë program në kohën e duhur.

Në kuadër të Komitetit të Menaxhimit të Programit CARDS, Greqia ka mbështetur fuqimisht caktimin e fondeve për financimin e projekteve në Shqipëri. Shuma e burimeve dhënë Shqipërisë nga programi CARDS për periudhën 2001 – 2005 është 232,9 milionë euro.

Në kuadër të nismës së Komunitetit European INTERREG III A, Organizata Greke e Nxitjes së Eksporteve – HEPO ka nënshkruar tri letra angazhuese me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë së Gjirokastrës, Përmetit dhe Sarandës dhe një letër angazhuese me Këshillin e Qarkut të Gjirokastrës.

Të gjitha këto letra angazhimi shprehin vullnetin e partnerëve për të nxitur bashkëpunimin në nivel kompanish. HEPO ka si qëllim të bashkëpunojë ngushtë me institucionet e mësipërme kur të aktivizohen masat relative të INTERREG III A Greqi – Shqipëri.

Të dyja palët shprehën kënaqësinë për nënshkrimin në korrik 2004 të një “Memorandumi bashkëpunimi” ndërmjet Këshillit të Qarkut Gjirokastrë e njësisë të tjera të qeverisjes lokale dhe rajonit të Janinës në kuadër të INTERREG III.

Bashkëpunimi rajonal

Të dyja palët theksuan rëndësinë e bashkëpunimit të tyre në kuadër të organizatës BEDZ (Bashkëpunimi ekonomik i Detit të Zi) dhe SECI (Nisma juglindore bashkëpunuese).

5. Bashkëpunimi dypalësh në fushën e ndihmës për zhvillim

Pala greke informoi palën shqiptare si më poshtë:

- Shqipëria është një nga marrësit kryesorë të ndihmës greke për zhvillim.

- Gjatë periudhës 1997 – 2003, Greqia i ka dhënë Shqipërisë ndihmë zyrtare zhvillimi (ODA) në shumën 182,49 milionë dollarë. Theks i veçantë është vënë ndaj sektorëve të infrastrukturës sociale dhe të arsimit, ndërtimit të paqes, shëndetësisë, mbështetjes së buxhetit kombëtar, ndihmës ushqimore, modernizimit të qeverisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

- Deri në vitin e kaluar, rëndësi e veçantë i është dhënë monitorimit të ngushtë të menaxhimit të ujërave ndërkufitare.

- Pala greke nënvizoi se Shqipëria vazhdon të jetë një vend prioritar për politikën e bashkëpunimit grek të zhvillimit, me theks të veçantë për sektorët e infrastrukturës sociale dhe të arsimit, mjedisit, menaxhimit të ujërave dhe trafikut njerëzor.

Të dyja palët ranë dakord për përshejtimin e procedurave për sigurimin efektiv të grantit prej 500 000 euro për pajisjen e spitalit të maternitetit të Tiranës.

Pala greke rikujtoi se shuma prej 2,5 milionë euro caktuar për Teatrin Kombëtar në Tiranë është depozituar në Bankën Qendrore të Shqipërisë që prej dhjetorit 2001 dhe i kërkoi palës shqiptare të vazhdojë me të gjitha procedurat e nevojshme.

6. Ndjekja e mekanizmit të zbatimit të huasë greke

Rreth materializimit të huasë greke:

i) Huaja greke për programin e strehimit

Pala shqiptare do të vlerësonte faktin që pala greke të përshejtonte procedurat e saj të disbursimit të pjesës së mbetur të fondeve në kuadër të marrëveshjes për programin e strehimit. Pala shqiptare do të vlerësonte një reagim nga pala greke mbi këtë çështje. Detyrimet e palës shqiptare sipas këtyre kërkesave janë plotësuar.

Në kuadër të këtij programi, shuma prej 10% e gjithë totalit ose 500 mil. GRD u disbursua në fillim të vitit 2002 dhe me të u blenë 125 apartamente. Nga pala shqiptare janë plotësuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja në fjalë.

ii) Huaja për mbështetjen e sektorit privat

Pala shqiptare i parashtrroi palës greke kërkesën mbi përdorimin e pjesës së mbetur të huasë që lidhet me mbështetjen e kompanive private në shumën prej 3,916 milionë GRD (dhrakmi) nëpërmjet formave të ndryshme të mbështetjes ekonomike dhe financiare të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

iii) Infrastruktura sociale

Pala shqiptare i paraqiti palës greke kërkesën e saj për të përshejtuar procedurat për materializimin e huasë në sektorin e arsimit në shumën prej 1.5 miliard GRD (dhrakmi).

7. Plani grek për rindrtimin ekonomik të Ballkanit - Shqipëri

Marrëdhëniet ekonomike do të inkurajohen më tej nga plani grek për rindërtimin ekonomik të Ballkanit (HPERB – ESOAB sipas akronimeve greke). Buxheti total në dispozicion, veçanërisht për Shqipërinë, arrin shumën 49,890.00 euro gjatë periudhës 2002 – 2006. Deri tani janë dorëzuar katër (4) propozime zyrtare dhe pas marrëveshjes së fundit midis palës shqiptare dhe greke, përparësi e plotë do t'i jepet bashkëfinancimit të rrugës Sagiadas – Saranda. Ndërkohë, vazhdojnë të mbeten nën shqyrtim pika e re e kalimit kufitar të Konispolit dhe rruga Korçë – Pogradec.

Ekspertë nga të dyja palët do të takohen për të diskutuar modalitetet për shqyrtimin e kësaj marrëveshjeje në bazë të nenit 10.

Lidhur me fondin e projekteve të vogla, janë miratuar për zbatim tre (3) propozime dhe janë duke u zhvilluar procedurat dhe përgatitjet përkatëse. Përsa i përket investimeve private, deri tani, Ministria e Ekonomisë dhe e Financës ka miratuar nëntë (9) propozime për investime private. Shuma totale e granteve për këto investime private shkon në 6,926.271 euro.

8. Shqyrtimi i borxhit të jashtëm shqiptar ndaj Greqisë

Borxhi shqiptar ndaj Greqisë përbëhet nga:

a) Borxhi nga kredia prej 23,4 milionë të dhëna shtetit shqiptar nga një konsorcium i bankave greke.

b) Borxhi në USD nga transaksionet me klering në përputhje me një veprim bankar (marrëveshje ndërbankare e 19.11.87) midis ish-shtetit shqiptar dhe Bankës së Greqisë.

c) Borxhi i mbetur ndaj dy kompanive private greke që ka lindur si rezultat i eksporteve të kompanitë shtetërore shqiptare në vitin 1991.

Pala shqiptare mori përsipër detyrimin për të paraqitur shumat e mbetura në lidhje me sa më sipër (a, b, c) natyrën e borxheve deri në 30.6.2005.

Të dyja palët ranë dakord që deri në muajin shtator 2005 do të bien në ujdi për shumën e mbetur të borxheve.

Pas kësaj, brenda një periudhe prej dy muajsh, do të mbahet një takim i përfaqësuesve të të dyja palëve që do të vendosin për ripagesat e borxhit.

Të dyja palët ranë dakord që sesioni i 10-të i Komitetit ndërqeveritar shqiptaro-grek për bashkëpunimin ekonomik, industrial dhe tekniko-shkencor të zhvillohet në Tiranë, në një datë e cila do të caktohet në rrugë diplomatike.

Bërë më 29 mars 2005 në Janinë, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Në emër të Këshillit të Ministrave të
Republikës së Shqipërisë

ANASTAS ANGJELI
Ministër i Ekonomisë

Në emër të Qeverisë së Republikës
të Greqisë

EVRIPIDIS STYLIANIDIS
Zëvendësministër i Punëve të Jashtme

VENDIM

Nr. 540, datë 27.7.2005

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË SESIONIT TË TRETË, TË KOMISIONIT TË PËRBASHKËT SHQIPTARO-AUSTRIAK, PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të sesionit të tretë, të Komisionit të Përbashkët Shqiptaro-Austriak, për bashkëpunimin ekonomik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PROTOKOLL

I SESIONIT TË TRETË TË KOMISIONIT TË PËRBASHKËT SHQIPTARO-AUSTRIAK PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK

Sesioni i tretë i Komisionit të Përbashkët shqiptaro-austriak për bashkëpunimin ekonomik u zhvillua në Vjenë më 11-12 prill 2005, në bazë të nenit 12 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Ekonomik ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë, të nënshkruar në Vjenë më 29 mars 1994.

Delegacioni shqiptar u kryesua nga Z. Luan Shahollari, zëvendësministër i Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë, dhe delegacioni austriak u kryesua nga Z. Josef Mayer, zëvendësministër, drejtor i Drejtorisë për Politikën e Jashtme Ekonomike dhe të Integritimit European në Ministrinë Federale të Çështjeve Ekonomike dhe të Punës të Republikës së Austrisë.

Anëtarët e të dy delegacioneve janë të shënuar përkatësisht në anekset I dhe II të këtij protokollit. Sesioni i tretë i Komisionit miratoi rendin e ditës në aneksin III.

Sesioni i tretë i Komisionit të Përbashkët u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë, miqësore dhe të mirëkuptimit reciprok, e cila pasqyrore dëshirën dhe vendosmërinë e të dy vendeve për gjetjen e rrugëve praktike, të realizueshme dhe efektive për të rritur dhe diversifikuar më tej marrëdhëniet ekzistuese në sektorët e ndryshëm të ekonomive përkatëse.

Rezultatet e bisedimeve janë të përmbledhura në vijim:

1. Shqyrtimi i gjendjes ekonomike në të dy vendet

Të dyja palët shkëmbyen informacione mbi gjendjen ekonomike në vendet e tyre përkatëse dhe ranë dakord se, nisur nga shenjat pozitive të zhvillimit të ekonomisë shqiptare, mund të priten përmirësime të mëtejshme të marrëdhënieve dypalëshe ekonomike dhe tregtare.

2. Gjendja dhe zhvillimi i marrëdhënieve tregtare dypalëshe

Të dyja palët shprehën kënaqësinë për rritjen e shënuar që nga sesioni i kaluar në volumin e tregtisë dypalëshe, si edhe nënvizuan që ky volum nuk përfaqëson potencialet reale të ekonomive të të dy vendeve.

Pala shqiptare informoi palën austriake se volumi i eksportit në Austri në vitin 2004 arriti nivelin e 4,7 milionë USD, kundrejt vetëm 745 mijë USD në vitin 2002. Volumi i tregtisë midis të dy vendeve në vitin 2004 ishte 33,6 milionë USD kundrejt 19.6 milionë USD në vitin 2002, me një rritje prej 71 për qind.

Pala austriake vuri në dukje se sipas statistikave të tregtisë së jashtme austriake, në krahasim me vitin 2003, eksportet austriake drejt Shqipërisë janë rritur më tej gjatë vitit 2004 me +38,6 % në 24,4 milionë euro dhe gjithashtu importet austriake nga Shqipëria janë rritur gjatë së njëjtës periudhë me + 27,2% në 4,4 milionë euro.

Të dyja palët theksuan nevojën për të bërë përpjekje të mëtejshme për të rritur tregtinë dypalëshe në nivele më të larta mbi bazën e përfitimit reciprok.

Të dyja palët, në këtë drejtim, theksuan rëndësinë e vizitave të delegacioneve tregtare, organizimin e misioneve tregtare, si dhe pjesëmarrjen në panaire dhe ekspozita të organizuara në të dy vendet, dhe ranë dakord të inkurajojnë nismat e kësaj natyre.

Me qëllim rritjen e bashkëpunimit tregtar në të ardhmen, pala shqiptare shprehu gadishmërinë e saj për të intensifikuar kontaktet ndërmjet strukturave përkatëse të të dy vendeve.

3. Zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ekonomik dypalësh

Të dyja palët vlerësuan me kënaqësi se janë realizuar shumë nga objektivat e vendosura në protokollin e sesionit të dytë të Komisionit të Përbashkët (shtator 2002).

Të dyja palët theksuan rëndësinë e bashkëpunimit ekonomik dhe përmendën se gjatë viteve të fundit pala austriake ka financuar një numër projektesh në Shqipëri, kryesisht në sektorin e furnizimit me ujë, energjisë dhe arsimit. Përparësi gjeografike i është dhënë Shqipërisë Veriore.

Me qëllim rritjen e bashkëpunimit ekonomik dypalësh në të ardhmen, pala shqiptare propozoi:

- Vendosijen e kontakteve institucionale ndërmjet tri agjencive shqiptare të krijuara së fundmi, shprehimisht Agjencia e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, Agjencia e Nxitjes së Investimeve të Huaja Direkte dhe Agjencia e Nxitjes së Eksporteve dhe homologëve të tyre në Austri;

- Konsolidimin e marrëdhënieve midis institucioneve homologe në mbështetje të biznesit.

Prioritetet e bashkëpunimit sipas sektorëve

3.1 Turizmi

Të dyja palët theksuan rëndësinë e turizmit për ekonominë përkatëse kombëtare dhe informuan mbi rezultatet në turizëm gjatë vitit 2004.

Të dyja palët do të nxisin bashkëpunimin ndërmjet kompanive të turizmit, veçanërisht ndërmjet investitorëve.

Të dyja palët ranë dakord që të shkëmbejnë informacion në fushën e turizmit.

Të dyja palët ranë dakord të bashkëpunojnë në projektin “Turizmi në Shqipërinë e Jugut” në kuadër të projektit të Bankës Botërore “Menaxhimi i zonës së integruar bregdetare” dhe “Programi i pastrimit”.

Bashkëpunimi i Zhvillimit Austriak (OEZA) ofroi asistencë të mbështetjes së projektit në kontekst të investimeve private austriake (FDI) në sektorin e turizmit, si ndihmesë teknike në trajnimin profesional për formimin profesional në fushën e turizmit siç ishte siguruar edhe në të kaluarën.

Pala shqiptare shprehu interes për përvojën austriake në turizmin malor, si dhe gjithashtu për bashkëpunim me palën austriake në lidhje me turizmin bregdetar.

3.2 Bujqësia

Të dyja palët do të nxisin bashkëpunimin midis instituteve kërkimore shqiptare dhe austriake për programe të përbashkëta të zhvillimit të zonave bujqësore duke synuar rritjen e qëndrueshmërisë dhe mbrojtjes, burimeve natyrore.

Pala shqiptare parashtrroi kërkesën për mbështetje dhe asistencë teknike nga pala austriake lidhur me krijimin dhe konsolidimin e shoqatave të fermerëve në bujqësi.

Të dyja palët ranë dakord për mbështetjen profesionale të fermerëve shqiptarë nga pala austriake.

Të dyja palët shprehën vlerësimin e tyre për bashkëpunimin pozitiv të Shoqatës së Dyfishtë të Rritësve të Gjedhit që prej formimit të saj në vitin 2002. Gjithashtu u theksuan edhe shërbime shtesë austriake, të tilla si oferta për këshilla shtesë (seminare, kurse, materiale informuese), si dhe ngritja e qendrave shpërndarëse të rritjes së gjedhit. Të dyja palët do të nxisin bashkëpunimin dhe do të shkëmbejnë informacion në fushën e ndërzimit të gjedhit.

Pala austriake kujtoi mundësinë e trajnimit profesional në fushën e bujqësisë, mbarështimin e kafshëve, menaxhimin ujqor dhe pyjor, në mbështetje të fermerëve në Shqipëri.

Të dyja palët ranë dakord për shkëmbimin e përvojës në fushën e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve.

Pala shqiptare shprehu interes lidhur me sigurimin e mbështetjes nga pala austriake lidhur me përafrimin e legjislacionit për sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve.

Të dyja palët do të nxisin bashkëpunimin midis instituteve kërkimore për programe të përbashkëta, duke synuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e pyjeve (veçanërisht brenda kuadrit të Projektit të Zhvillimit të Burimeve Natyrore (NRDP)) dhe të burimeve natyrore.

3.3 Mjedisi

Pala austriake mori dijeni për nevojat e Shqipërisë rreth çështjeve të mjedisit dhe shprehu vullnetin e saj për të punuar së bashku ngushtësisht.

Të dyja palët ranë dakord të inkurajojnë kontaktet dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të tyre përkatëse në mënyrë që të punojnë mbi projekte konkrete në fushën e mjedisit.

3.4 Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Të dyja palët ranë dakord të forcojnë bashkëpunimin rreth çështjeve që kanë të bëjnë me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SMEs)

Pala austriake është aktualisht e gatshme të japë ndihmesë në zhvillimin e sektorit privat të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në nivelin mikroekonomik, ashtu dhe në atë makroekonomik. Në varësi të ekzistencës së burimeve financiare austriake, mund të bashkëpunohet në intensifikimin e kontakteve dhe shkëmbimin e përvojës midis institucioneve dhe bizneseve përkatëse të të dy vendeve dhe gjithashtu në realizimin e projekteve dhe programeve të përbashkëta.

3.5 Punët publike (sektori i ujit)

Bashkëpunimi Austriak i Zhvillimit shprehu angazhimin e tij për të mbështetur më tej veprimtaritë në sektorin ujor të bashkisë së Shkodrës. Pala austriake e informoi delegacionin shqiptar që negociatat tripalëshe pritet të fillojnë nga fillimi i vitit tjetër. Mbështetur në një studim që aktualisht është ndërmarrë nga KfW-Kreditanstalt für Wiederaufbau (Gjermani), Bashkëpunimi Austriak i Zhvillimit, së bashku me palën shqiptare dhe KfW do të diskutojnë për mundësinë e mbështetjes së mëtejshme të projektit të financuar nga Austria.

Të dyja palët ranë dakord për bashkëpunim të mëtejshëm në këtë fushë.

3.6 Transporti

Të dyja palët vlerësuan takimin e Komisionit të Përbashkët shqiptaro-austriak mbi transportin rrugor, të zhvilluar muajin e kaluar në Vjenë, gjatë të cilit u negociua dhe përafërua një Marrëveshje e re mbi Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave.

Pala shqiptare ftoi firmat austriake që të marrin pjesë në tenderat ndërkombëtarë që do të zhvillohen lidhur me infrastrukturën rrugore, porteve dhe aeroporteve.

Pala shqiptare kërkoi asistencë nga pala austriake në fushën e standardeve dhe kushteve teknike në infrastrukturën e transportit, si dhe trajnime eventuale në këtë drejtim.

Të dyja palët theksuan nevojën e një bashkëpunimi më të madh në fushën e transportit hekurudhor sipas drejtimeve dhe fushave të përcaktuara në Marrëveshjen ndërmjet Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë Federale e Shkencës dhe Transportit të Republikës së Austrisë në lidhje me bashkëpunimin në fushën e sistemit hekurudhor”, të nënshkruar në Vjenë më 9 korrik 1998.

Të dyja palët ranë dakord që ky bashkëpunim të fokusohet në modernizimin e terminalit të Shkodrës për transportin e udhëtarëve, në rikonstrukcionin e linjës hekurudhore Vorë-Shkodër-kufiri me Malin e Zi, si dhe në furnizimin e Hekurudhës Shqiptare me pajisje dhe mjete për mekanizimin e mirëmbajtjes hekurudhore.

3.7 Energjia

Pala austriake informoi palën shqiptare që aktualisht është duke u përgatitur nga Agjencia Austriake e Zhvillimit (ADA) një ofertë për të mbështetur edhe më tej projektin e rehabilitimit të kaskadës së lumit Drin. Oferta përmban një mbështetje financiare që arrin në dy milionë euro. Paketa financiare përbëhet nga një element granti (në nivelin 0,7 milionë euro) dhe nga një element kredie (1,3 milionë euro).

Pala shqiptare shprehu interes lidhur me:

- Bashkëpunimin për zhvillimin e burimeve të energjive të rinovueshme, si burimet hidrike, të diellit dhe të erës në Shqipëri;
- vijimin e bashkëpunimit në fushën e kërkimit të naftës dhe të gazit në Shqipëri;
- pjesëmarrjen e kompanive austriake në proceset e privatizimit të sektorit të energjisë (naftë, gaz dhe energji elektrike) në Shqipëri;
- nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kërkimore-shkencore të të dy vendeve.

Pala austriake, duke qenë e ngarkuar/përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut dhe legjislacionit në çështjet e inxhinierisë elektrike, ku përfshihen rregullat kombëtare dhe përafrimi i legjislacionit të brendshëm me legjislacionin e BE-së (Direktiva e Voltazhit të Ulët, Direktiva EMC, Direktiva ATEX, si dhe Direktivat e Etiketimit të Energjisë dhe e Efektivitetit të Energjisë), mund të ofrojë mbështetje në hartimin e legjislacionit përkatës në Shqipëri në pajtim me kërkesat e BE-së për premisat në drejtim të rritjes së tregtisë në këtë sektor.

3.8 Minierat dhe gjeologjia

Të dyja palët nënvizuan rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit në fushën e minierave dhe të gjeologjisë.

Në fushën e minierave, pala shqiptare shprehu interes për bashkëpunim në fushat e poshtëshënuara:

- Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit në zonat e shfrytëzuara të mineraleve si, bakri, kromi, qymyrguri etj.

- Përpunimi i materialeve të ndërtimit me karakteristika të larta cilësore.

- Shfrytëzimi i gurëve dekorativë;

Pala shqiptare propozoi vendosjen e kontakteve të rregullta ndërmjet shërbimeve gjeologjike respektive.

3.9 Financat

Të dyja palët vlerësuan fillimin e negociatave teknike lidhur me Marrëveshjen për mënjanimin e taksimit të dyfishtë, eliminimin e evazionit fiskal, bashkëpunimin në fushën e doganave dhe në luftën kundër pastrimit të parave.

Lidhur me sektorin bankar, të dyja palët theksuan rëndësinë e privatizimit të Bankës Shqiptare të Kursimeve nga Banka Austriake “Raiffeisen Bank”.

Të dyja palët ranë dakord që të forcojnë bashkëpunimin në fushat e poshtëshënuara:

- luftën kundër pastrimit të parave;

- përfundimin e marrëveshjes për mënjanimin e taksimit të dyfishtë;

- arritjen e një marrëveshjeje binjakëzimi midis ministrive respektive të dy vendeve për shkëmbimin e njohurive dhe praktikave më të mira në fushën e financave publike.

3.10 Programi Austriak për Zhvillim

Të dyja palët theksuan rëndësinë e Programit Austriak për Zhvillim me vendet e Europës Juglindore. Reduktimi i lëvizjeve të pakontrolluara dhe dhënia e një kontributi në përmirësimin e ekuilibrit social përbëjnë synimet kryesore të këtij Programi për Shqipërinë. Programi Austriak për Zhvillim do të veprojë në vijimësi në Shqipëri lidhur me përmirësimin e infrastrukturës, krijimin e vendeve të punës, forcimin e strukturave administrative lokale dhe modernizimin e shoqërisë.

4. Marrëdhëniet Shqipëri-BE

4.1 Zhvillimet në kuadër të Procesit të Stabilizimit dhe Asocimit

Të dyja palët ranë dakord se Procesi i Stabilizim-Asocimit (PSA) në Shqipëri është intensifikuar që nga hapja zyrtare e negociatave ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit më 31 janar 2003, si dhe me miratimin e dokumentit të Partneritetit Europian më 14 qershor 2004. Deri tani, janë organizuar 14 raunde negociatash dhe është përfunduar “leximi i parë” i tekstit të Marrëveshjes.

Pala shqiptare informoi se në përgjigje të Partneritetit Europian, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka miratuar Planin Kombëtar të Veprimit për Zbatimin e Prioriteteve të Partneritetit Europian më 30 gusht 2004. Plani i Veprimit identifikon masat prioritare që duhet të ndërmerren me qëllim realizimin e objektivave prioritare në kuadër të SAP-së brenda një periudhe afatshkurtër (1-2 vjet) dhe një periudhe afatmesme (3-4 vjet).

Të dyja palët ranë dakord të inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve respektive shqiptare dhe austriake drejt përshpejtimit të procesit të integritimit të Shqipërisë në strukturat e BE-së.

4.2 Bashkëpunimi në kuadrin e Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore

Të dyja palët nënvizuan rëndësinë e mbështetjes financiare austriake për bashkëpunimin rajonal (kryesisht në kuadrin e Paktit të Stabilitetit), e cila i shërben lidhjes së Shqipërisë me vendet e tjera të Europës Juglindore. Mbështetja e bashkëpunimeve rajonale synon arritjen e stabilitetit të qëndrueshëm, zhvillimin ekonomik dhe integrimin e rajonit në strukturat europiane. Shembuj projektesh të tilla janë Investment Compact (Mbështetja e sektorit privat), ERISSE (Task Force Education and Youth), si dhe Balkan Case Challenge, një konkurs i përvitshëm për studentët nga Jugu i Europës.

Pala shqiptare vlerësoi kontributin e Austrisë si bashkëkryesuese e Nismës së Kompaktit të Investimeve, e cila si komponent kyç i Paktit të Stabilitetit (në bashkëpunim me OECD), luan një rol të rëndësishëm në proceset transformuese në vendet e rajonit, veçanërisht në nxitjen e investimeve. Gjithashtu, të dyja palët shënuan rëndësinë e aktivitetit në nivel ministror të Kompaktit të Investimeve, i cili zhvillohet çdo vit në Vjenë. Deklarata Ministrore e Vjenës e korrikut 2004 vuri theksin në rritjen e fluksit të investimeve të huaja. Në këtë kontekst, të dyja palët nënvizuan progresin e Shqipërisë, ku investimet e huaja në vitin 2004 kapën shifrën 341 milionë USD përkundrejt 178 milionë USD të vitit 2003.

4.3 Regjimi tregtar rajonal – Marrëveshjet e tregtisë së lirë

Të dyja palët theksuan se e konsiderojnë integrimin rajonal në Europën Juglindore si një politikë që konsolidon rritjen ekonomike të qëndrueshme në vendet e rajonit dhe si një parakusht të integritit të këtyre vendeve në Bashkimin Europian.

Në këtë kontekst, pala shqiptare informoi palën austriake lidhur me përfundimin e tetë marrëveshjeve të tregtisë së lirë, të cilat janë tani në fazën e zbatimit. Si rezultat i zbatimit të këtyre marrëveshjeve, janë rritur eksportet shqiptare në vendet e rajonit.

4.4 Projekti rajonal CARDS (sektori i drejtësisë)

Projekti CARDS rajonal “Krijimi i një sistemi gjyqësor të pavarur, të besueshëm dhe funksional dhe forcimi i bashkëpunimit gjyqësor në vendet e Ballkanit Perëndimor” ka filluar veprimtarinë që prej muajit maj 2004 nën drejtimin e Ministrisë Federale Austriake të Drejtësisë. Projekti prej 5,5 milionë euro do të vihet në jetë brenda tre vjetëve të ardhshëm, në bashkëpunim me ministrinë e drejtësisë të disa vendeve europiane, si dhe të Këshillit të Europës.

5. Gjendja lidhur me OBT

Pala austriake nënvizoi që marrëveshja e vendeve anëtare të OBT-së mbi të ashtuquajturën “Paketa e Korrikut” ishte një sinjal shumë pozitiv dhe inkurajues për politikën ekonomike shumëpalëshe; sidoqoftë, për të pasur një përparim të shpejtë, të gjitha përpjekjet duhen përqendruar në negociatat që po zhvillohen aktualisht. Në lidhje me përgatitjet për Konferencën e ardhshme Ministrore në Hong Kong, do të ishte e rëndësishme që të arrihej përqaqja e parë rreth çështjeve themelore deri në muajin qershor 2005, në mënyrë që të shtrohej rruga për përfundimin me sukses të saj.

Pala shqiptare informoi se, me pranimin në OBT në shtator të vitit 2000, Qeveria shqiptare plotësoi me sukses një nga objektivat më të rëndësishme të ekonomisë shqiptare, duke bërë të mundur në këtë mënyrë pjesëmarrjen aktive të Shqipërisë në regjimin tregtar shumëpalësh. Anëtarësimi në OBT dhe zbatimi i angazhimeve përkatëse pasqyron përpjekjet e Shqipërisë për të arritur standarde ekonomike që synojnë ta bëjnë atë anëtarë të Bashkimit Europian. Objektivi kryesor i Qeverisë shqiptare është sigurimi i një pozicioni korrekt në këtë organizatë nëpërmjet zbatimit rigoroz të angazhimeve që rrjedhin nga anëtarësimi.

Çështje shqiptare dhe austriake

Data dhe vendi i sesionit të ardhshëm

Të dyja palët vendosën që të mbajnë sesionin e katërt të Komisionit të Përbashkët shqiptaro-austriak për bashkëpunimin ekonomik në Tiranë, në një datë e cila do të përcaktohet në rrugë diplomatike.

Bërë dhe nënshkruar më 12 prill 2005 në Vjenë, në dy ekzemplarë origjinalë në gjuhën angleze, të dy tekstet njëilloj të vlefshme.

Për delegacionin shqiptar

Për delegacionin austriak

Z. Luan SHAHOLLARI
Zëvendësministër i Ministrisë së Ekonomisë

Z. Josef MAYER
Zëvendësministër
Drejtor i Drejtorisë për Politikën e Jashtme
Ekonomike dhe të Integritit Europian

VENDIM
Nr. 541, datë 27.7.2005

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT TË
FSHATIT SHELEGAR, NË QYTETIN E SARANDËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private (tokë arë), z.Theodhori Cato, që preket nga ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Shelegar, në qytetin e Sarandës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Sarandës.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet, në vlerë të plotë, për sipërfaqen 50 m² tokë arë, me vlerë 1000 lekë/m², vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 108 500 (një qind e tetë mijë e pesëqind) lekë.

5. Fondi prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, për shpronësimin e pronarit, dhe fondi prej 108 500 (njëqind e tetë mijë e pesëqind) lekësh, për shpenzimet procedurale, të përballohen nga bashkia e Sarandës.

6. Punimet të përfundojnë brenda muajit gusht 2005.

7. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda muajit korrik 2005.

8. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe bashkia e Sarandës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 542, datë 27.7.2005

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 4 të nenit 26 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.153, datë 25.4.2002 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

STATUTI
I SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

KREU I
STATUSI DHE MISIONI I SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Neni 1

Shërbimi Social Shtetëror është institucion shtetëror, me qendër në Tiranë, në vartësi të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale. Roli dhe përgjegjësitë e tij rregullohen me këtë statut.

Neni 2

Shërbimi Social Shtetëror ka për mision zbatimin e politikave, legjislacionin e ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin. Këtë mision e realizon nëpërmjet:

- a) inspektimit, monitorimit të standardeve të shërbimeve sociale të ofruara nga operatorët publikë, privatë dhe OJF-të në të gjithë vendin;
- b) programimit dhe detajimit të fondeve të ndihmës ekonomike;
- c) programimit dhe detajimit të fondeve të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;
- d) programimit dhe detajimit të fondeve për shërbimet shoqërore;
- e) kontrollit të përdorimit të fondeve buxhetore për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimet e shoqërore.

KREU II
DETYRAT E SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR SIPAS FUSHAVE TË VEPRIMTARISË

Neni 3

Për shërbimet shoqërore

Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror dhe në nivel qarku ka detyrat si vijojnë:

- a) Harton dokumentacionin tip për aplikantët dhe përfituesit e shërbimeve shoqërore.
- b) Programon fondet e Buxhetit të Shtetit për shërbimet shoqërore sipas vlerësimit të nevojave nga qeverisja vendore dhe mundësive të Buxhetit të Shtetit.
- c) Detajon, që në fillim të vitit, fondet për financimin e shërbimeve shoqërore.
- d) Organizon dhe drejton procesin e inspektimit të përdorimit të fondeve të buxhetit për shërbimet shoqërore.
- e) Organizon e drejton inspektimin për zbatimin e standardeve të përgjithshme, si dhe specifike të shërbimeve shoqërore që realizojnë OJF-të dhe operatorët e tjerë publikë dhe privatë.
- f) Propozon ngritjen e shërbimeve të reja dhe përmirësimin e standardeve të shërbimeve shoqërore.
- g) Pranon dokumentacionin e subjekteve publike dhe jopublike për licencimin/rilicencimin. Vlerëson mbi bazën e dokumentacionit dhe inspektimeve, kapacitetet e aplikuesit dhe bën propozimin për licencimin e tyre në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.
- h) Propozon heqjen e licencës për subjektet që nuk plotësojnë standardet në bazë të vlerësimeve të inspektorëve të shërbimeve shoqërore.
- i) Programon "Fondin shoqëror" për zbatimin e politikave dhe krijimin e shërbimeve të reja shoqërore në përputhje me nevojat e qarkut, bashkive/komunave.
- j) Mbledh, analizon dhe përpunon informacionin mbi ecurinë e shërbimeve shoqërore dhe raporton periodikisht në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale. Harton raportin vjetor të vlerësimit të nevojave për shërbime shoqërore dhe kapaciteteve të shërbimeve publike dhe jopublike.
- k) Menaxhon institucionet e përkujdesit shoqëror me karakter kombëtar deri në fund të vitit 2007.

l) Kryen komisionimin për pranimin e personave të kategorive të ndryshme shoqërore që vendosen në institucionet publike të përkujdesit shoqëror me karakter nacional deri në fund të vitit 2007.

m) Bashkëpunon dhe koordinon punën me qarqet për funksionimin e komiteteve rajonale të planifikimit të përkujdesit komunitar për vlerësimin e nevojave dhe hartimin e planeve të përkujdesit.

n) Bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet/shërbimet që ofrohen nga OJF-të dhe donatorët e huaj dhe propozon shpërndarjen e tyre në territorin e vendit.

Neni 4

Për ndihmën ekonomike

Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror dhe në nivel qarku ka detyrat si vijojnë:

- a) Harton dokumentacionin tip për aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.
- b) Programon fondet e Buxhetit të Shtetit për ndihmën ekonomike për çdo njësi të qeverisjes vendore në përputhje me vlerësimin e nevojave të familjeve dhe individëve në nevojë.
- c) Detajon në fillim të vitit në nivel dymujor fondet e ndihmës ekonomike për çdo bashki komunë në përputhje me vlerësimin e nevojave dhe të burimeve të Buxhetit të Shtetit.
- d) Detajon çdo katërmujor fondet për financimin e ndihmës ekonomike në bashki/komunë për shpërndarjen e ndihmës ekonomike, që kushtëzohet me punë e shërbime në komunitet.
- e) Organizon dhe drejton procesin e inspektimit të zbatimit të legjislacionit për shpërndarjen e fondeve të ndihmës ekonomike nga njësitë e pushtetit vendor për familjet dhe individët në nevojë.
- f) Mbledh dhe analizon informacionin dhe statistikën mbi shpërndarjen e ndihmës ekonomike nga njësitë e qeverisjes vendore dhe raporton periodikisht në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

Neni 5

Për pagesën e personave me aftësi të kufizuar

Shërbimi Social Shtetëror, në nivel qendror dhe në nivel qarku, ka detyrat si vijojnë:

- a) Harton dokumentacionin tip për aplikuesit dhe përfituesit që pretendojnë të përfitojnë nga aftësia e kufizuar.
- b) Programon fondet e Buxhetit të Shtetit për pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe invalidët e punës, për çdo njësi të qeverisjes vendore.
- c) Detajon, që në fillim të vitit, si dhe çdo dy muaj, fondet për pagesën për personat me aftësi të kufizuar dhe invalidët e punës për çdo bashki/komunë.
- d) Organizon dhe drejton procesin e inspektimit të shpërndarjes së fondeve nga njësitë e pushtetit vendor për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar.
- e) Menaxhon procesin e vlerësimit në Komisionin Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë për përfitimin e aftësisë së kufizuar nga të verbërit në përputhje me statutin ligjor të tyre.
- f) Menaxhon procesin e vlerësimit për personat me aftësi të kufizuar në Komisionin Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.
- g) Mbledh, analizon informacionin dhe statistikën për pagesën e aftësisë së kufizuar nga njësitë e qeverisjes vendore dhe raporton periodikisht në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Neni 6

Për administrimin e përgjithshëm

Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror ka detyrat si vijojnë:

- a) Menaxhon burimet materiale dhe financiare të administratës qendrore e rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.
- b) Programon trajnimin e burimeve njerëzore në nivel qendror e rajonal të Shërbimit Social Shtetëror.

c) Harton programet kualifikuese për stafet në nivel qendror e lokal dhe kurrikulat përkatëse.

d) Harton kriteret specifike për rekrutimin e stafit në nivel qendror dhe rajonal.

e) Drejton procesin e informimit publik, marrëdhëniet me institucionet e interesuara dhe aktorë të tjerë shoqërorë.

f) Koordinon veprimtarinë me institucione, organizma ndërkombëtarë dhe donatorë të vendit e të huaj me interes në fushën e shërbimeve shoqërore.

g) Vlerëson gjendjen për kategoritë e personave me aftësi të kufizuar, në përputhje me statutet e tyre ligjore.

KREU III

DREJTIMI DHE ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Neni 7

Organet vendimmarrëse dhe drejtuese

Organi më i lartë vendimmarrës në Shërbimin Social Shtetëror është Këshilli Administrativ. Autoriteti më i lartë ekzekutiv është Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 8

Këshilli Administrativ

Këshilli Administrativ i Shërbimit Social Shtetëror përbëhet nga 12 anëtarë dhe 1 kryetar, i cili është Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale. Anëtarët e Këshillit janë përfaqësues në nivel zëvendësministri apo drejtor drejtorie për ministritë, në nivel drejtori për institucionet e tjera, si më poshtë:

- a) Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale
- b) Ministria e Financave
- c) Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit
- d) Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit
- e) Ministria e Shëndetësisë
- f) Shërbimi Social Shtetëror
- g) Instituti i Sigurimeve Shoqërore
- h) Shërbimi Kombëtar i Punësimit
- i) Instituti i Kujdesit Shëndetësor
- j) Fakulteti i Shkencave Sociale
- k) Përfaqësues të shoqatave të personave me aftësi të kufizuar
- l) Përfaqësues të shoqatave të fëmijëve.

Neni 9

Emërimin nominal të anëtarëve të Këshillit Administrativ e bën Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, me propozim të titullarëve të institucioneve të lartpërmendura dhe OJF-ve, për një periudhë dyvjeçare.

Neni 10

Këshilli Administrativ miraton rregulloren e funksionimit të tij. Këshilli mbledhet jo më pak se 4 herë në vit. Mbledhjet thirren nga Kryetari i Këshillit Administrativ ose Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-it. Për pjesëmarrjen në mbledhjet e Këshillit, anëtarët marrin shpërblim, në masën 15 mijë lekë, për çdo mbledhje.

Neni 11

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror kryen veprimtari ekzekutive dhe organizohet në drejtori dhe sektorë.

Neni 12

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror

Drejtori i Përgjithshëm është autoriteti më i lartë ekzekutiv i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Neni 13

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për punën e tij përpara Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale. Ai emërohet dhe lirohet nga detyra nga Kryeministri me propozim të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.

Neni 14

Kompetencat e Këshillit Administrativ

Këshilli Administrativ ka këto kompetenca:

- a) Shqyrton projektaktet ligjore dhe nënligjore, që propozohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror në zbatim të programeve të shërbimeve shoqërore.
- b) Miraton bilancin, raportin vjetor dhe projektbuxhetin për vitin pasardhës.
- c) Miraton strukturën e Shërbimit Social Shtetëror, rregulloren e organizimit dhe funksionit të tij.
- d) Shqyrton në parim kontratat dhe marrëveshjet me organizatat, institucionet apo donatorë që ushtrojnë aktivitete në fushën e shërbimeve shoqërore.
- e) Shqyrton dhe miraton formimin dhe përdorimin e "Fondit shoqëror".
- f) Shqyrton studime në fushën e ndihmës ekonomike, personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror.
- g) Propozon përmirësime në politikat dhe në legjislacionin e shërbimeve shoqërore.
- h) Miraton kurrikulat dhe programet e kualifikimit të stafeve në nivel qendror, rajonal dhe të operatorëve të tjerë publikë dhe jopublikë.

Neni 15

Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror ka këto kompetenca:

- a) Drejton veprimtarinë e Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal.
- b) Propozon në Këshillin Administrativ, strukturën dhe organikën e Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal.
- c) Propozon në Këshillin Administrativ rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.
- d) Miraton rregulloret e organizimit dhe të funksionimit të administratës së Shërbimit Social Shtetëror në nivel rajonal.
- e) Emëron dhe largon nga detyra, me miratim të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, drejtorët e drejtorive në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

f) Emëron dhe largon nga detyra me miratim të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, inspektorët e shërbimeve shoqërore dhe inspektorët e ndihmës ekonomike dhe pagesës së personave me aftësi të kufizuar në nivel qendror dhe në zyrat rajonale. Emëron drejtuesit dhe specialistët me arsim të lartë në strukturat e institucioneve të përkujdesit shoqëror .

g) Miraton programe kualifikuese për stafet në nivel qendror e lokal, që nuk përfshihen në programet e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

VENDIM

Nr. 543, datë 27.7.2005

PËR KUOTAT KRYESORE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË UNIVERSITETIN USHTARAK “SKËNDERBEJ” DHE TË KURSANTËVE PASUNIVERSITARË, PËR VITIN AKADEMIK 2005-2006

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31 e 35 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota kryesore e pranimit në universitetin ushtarak “Skënderbej”, për vitin akademik 2005-2006, të jetë 150 (njëqind e pesëdhjetë) studentë:

- | | |
|---------------------------|------------------------|
| a) Fakulteti i Menaxhimit | 100 (njëqind studentë) |
| b) Fakulteti Teknik | 50 (studentë). |

2. Kuota kryesore e pranimit në kursin e përgatitjes së oficerëve, për vitin akademik 2005-2006, të jetë 120 (njëqind e njëzet) kursantë pasuniversitarë.

3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr. 546, datë 3.8.2005

PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË, UNIVERSITARE, PUBLIKE, “UNIVERSITETI I FIERIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.8461, datë 25.9.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e shkollës së lartë, universitare, publike “Universiteti i Fierit”, me seli qendrore në qytetin e Fierit, me dy fakultete:

a) Fakultetin e Edukimit;
b) Fakultetin e Shkencave të Aplikuara.
2. Shkolla e lartë, universitare, publike “Universiteti i Fierit”, do të japë diplomë universitare në:

a) Fakultetin e Edukimit, në degët:
i) Cikël i Ulët, parashkollor (tre vite akademike);
ii) Cikël i Ulët (tre vite akademike);
iii) Punonjës social (tre vite akademike).

b. Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, në degët:
i) Inxhinieri agronomike (tre vite akademike);
ii) Prodhim blegtoral (tre vite akademike);
iii) Infermieri (tre vite akademike);
iv) Inxhinieri nafte (pesë vite akademike).

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 547, datë 3.8.2005

PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PUBLIKE “UNIVERSITETI I BERATIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.8461, datë 25.9.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e shkollës së lartë universitare publike “Universiteti i Beratit”, me seli qendrore në qytetin e Beratit, me dy fakultete:

a) Fakultetin e Edukimit;
b) Fakultetin e Shkencave të Aplikuara.

2. Shkolla e lartë universitare publike “Universiteti i Beratit” do të japë diplomë universitare në:

a) Fakultetin e Edukimit, në degët:
i) Cikël i ulët, parashkollor (tre vite akademike);
ii) Cikël i ulët (tre vite akademike);
b. Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, në degët:
i) Administrim Publik (tre vite akademike);
ii) Menaxhim-turizëm (tre vite akademike);
iii) Infermieri (tre vite akademike).

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 548, datë 3.8.2005

PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PUBLIKE “UNIVERSITETI I DURRËSIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.8461, datë 25.9.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e shkollës së lartë universitare publike, “Universiteti i Durrësit”, me seli qendrore në qytetin e Durrësit, me dy fakultete:
 - a) Fakultetin e Edukimit;
 - b) Fakultetin e Shkencave të Aplikuara.
2. Shkolla e lartë universitare publike “Universiteti i Durrësit” do të japë diplomë universitare në:
 - a) Fakultetin e Edukimit, në degët:
 - i) Cikël i ulët, parashkollor (tre vite akademike);
 - ii) Cikël i ulët (tre vite akademike);
 - iii) Gjuhë të huaja (tre vite akademike);
 - iv) Shkenca sociale (tre vite akademike).
 - b. Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, në degët:
 - i) Inxhinieri navale (pesë vite akademike);
 - ii) Menaxhin-turizëm (tre vite akademike).
3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 68, datë 28.7.2005

PËR MIRATIMIN E RREGULLORE “PËR MBIKËQYRJEN E KONSOLIDUAR”

Neni 1
Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj rregulloreje është ligji nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë të gjitha subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat për thjeshtësi dhe në vazhdim do të quhen “shoqëri”, që kanë në pronësi filiale dhe/ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera të licencuara ose jo nga Banka e Shqipërisë, brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Qëllimi i mbikëqyrjes së konsoliduar

Mbikëqyrja e konsoliduar vlerëson pozicionin ndaj rrezikut/rreziqeve jo vetëm të veprimtarisë së vet shoqërisë, por edhe të veprimtarisë së filialeve dhe të pjesëmarrjeve të saj.

Neni 4

Përcaktime

Për plotësimin e kërkesave të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë kuptimin që vijon:

1. Shoqëria konsoliduese dhe/ose shoqëria – mëmë quhet subjekti që ka në pronësi filiale dhe pjesëmarrje në shoqëritë e tjera.

2. Shoqëri të konsoliduara quhen filialet dhe pjesëmarrjet e shoqërisë konsoliduese.

3. Grupi i konsoliduar përbëhet nga shoqëria konsoliduese dhe shoqëritë e konsoliduara.

4. Filiali ka të njëjtin kuptim me nenin 2 pika 1 germa g të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit ky term “nënkupton çdo person juridik në të cilin një subjekt tjetër ose persona juridikë të lidhur, zotërojnë më shumë se pesëdhjetë për qind të kapitalit ose të aksioneve me të drejtë vote, duke e lejuar këtë subjekt ose personat juridikë të lidhur të ushtrojnë kontroll mbi të”.

5. Pjesëmarrje ka të njëjtin kuptim me nenin 2 pika 1 germa ë të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit ky term “nënkupton zotërimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të së drejtës së pronësisë së një aksionari në masën dhjetë për qind ose më shumë të kapitalit të personit juridik ose të aksioneve të tij me të drejtë vote, ose në një masë të tillë që krijon mundësi të ndikojë në drejtimin dhe politikën e personit juridik”.

Neni 5

Struktura e mbikëqyrjes së konsoliduar

Mbikëqyrja e konsoliduar përbëhet nga :

1. Kontabiliteti i konsoliduar,
2. Mbikëqyrja sasiore,
3. Mbikëqyrja cilësore.

Neni 6

Kontabiliteti i konsoliduar

1. Qëllimi i kontabilitetit të konsoliduar është pasqyrimi i gjendjes financiare të grupit të konsoliduar.

2. Organizimi i kontabilitetit të konsoliduar bëhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS 27, 28, 30, 31, 32, 39) dhe të Manualit të Kontabilitetit Bankar.

Neni 7

Mbikëqyrja sasiore

Mbikëqyrja sasiore është respektimi i kuadrit rregullator të mbikëqyrjes së konsoliduar, i cili përbëhet nga:

1. Kapitali rregullator në përputhje me udhëzimin “Për kapitalin rregullator”, formulari i të cilit, për qëllime të mbikëqyrjes së konsoliduar, zëvendësohet me formularin bashkëngjitur.

2. Mjaftueshmëria e kapitalit sipas rregullores “Për mjaftueshmërinë e kapitalit”.
3. Shpërndarja e rrezikut sipas rregullores “Për kontrollin e rreziqeve të mëdha”.
4. Marrëdhëniet me personat e lidhur sipas rregullores “Për marrëdhëniet e bankës me personat e lidhur me të”.
5. Mbulimi i rreziqeve të tregut sipas rregullores “Për rreziqet e tregut”.

Neni 8

Mbikëqyrja cilësore

Mbikëqyrja cilësore përqendrohet në analizën e cilësisë mbi baza të konsoliduara, kryesisht të:

1. Organizimit të kontrollit të brendshëm dhe drejtimit të rrezikut/rreziqeve.
2. Strukturës drejtuese dhe strukturës organizative.
3. Vlerësimit të rrezikut operacional, strategjik, reputacional dhe ligjor.
4. Vlerësimit të rrezikut sistemik në perspektivë.
5. Strategjisë së veprimtarive të brendshme ndërmjet shoqërisë konsoliduese dhe shoqërive të konsoliduara.
6. Mjaftueshmërisë së informacionit.
7. Vlerësimit të drejtimit sipas politikave të brendshme dhe zbatueshmërisë së tyre në praktikë.

Neni 9

Bashkëpunimi në kuadër të mbikëqyrjes së konsoliduar

1. Rritja e cilësisë së mbikëqyrjes së konsoliduar realizohet duke lidhur marrëveshje reciproke bashkëpunimi ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe autoriteteve mbikëqyrëse dhe rregullative të njësisë përbërëse të grupit të konsoliduar, brenda dhe jashtë vendit.

2. Banka e Shqipërisë ka të drejtë t’u kërkojë dhe t’u dërgojë raporte, të dhëna dhe informacion, autoriteteve mbikëqyrëse të vendeve të tjera, nëse ato janë të nevojshme për mbikëqyrjen e konsoliduar mbështetur në marrëveshje bashkëpunimi dhe mirëkuptimi, të nënshkruara midis palëve.

3. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kryejë inspektime në vend dhe/ose të marrë informacion në kuadër të bashkëpunimit për mbikëqyrjen e konsoliduar, për të kontrolluar vërtetësinë e raporteve dhe të të dhënave për mbikëqyrjen e konsoliduar.

Neni 10

Raportimi

1. Shoqëritë konsoliduese përgatisin dhe vërtetojnë pranë auditorëve të jashtëm pasqyrat financiare të konsoliduara. Këto pasqyra raportohen në Bankën e Shqipërisë brenda afateve ligjore, në fund të çdo viti financiar.

2. Shoqëritë përgatisin raportet vjetore të publikueshme mbi baza të konsoliduara (grupit të konsoliduar).

3. Në raportet vjetore të publikueshme, shoqëritë publikojnë listën e filialeve dhe të pjesëmarrjeve, të cilat janë përfshirë në pasqyrat e konsoliduara. Gjithashtu, në raportet vjetore përfshihet edhe lista e pjesëmarrjeve të cilat nuk janë konsoliduar, e shoqëruar me shënimet përkatëse.

4. Në zbatim të nenit 7 të kësaj rregulloreje, raportimet bëhen sipas përcaktimeve në aktet rregullative përkatëse.

5. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë për shoqëritë konsoliduese dhe/ose të konsoliduara.

Neni 11
Dispozitë përfundimtare

Kjo rregullore është miratuar me vendimin nr.68, datë 28.7.2005 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Ardian Fullani

<p>FORMULARI I RAPORTIMIT (kapitali rregullator për mbulimin e rreziqeve të kredisë)</p> <p>Emri i grupit bankar të konsoliduar Periudha raportuese Data e raportimit Përgatiti (Emër,mbiemër,firmë) Drejtuesi (Emër,mbiemër,firmë)</p>
--

në mijë Lekë.

	KAPITALI BAZË	Nr.llog.		Shuma
	I . Elementet përbërëse që shtohen (A) :			
1	Kapitali i nënshkruar	5711		
2	Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)	5731, 5733, 5734		
3	Primet e emetimit dhe të fuzionimit	572		
4	Fitimet e pashpërndara (e bartura)	577(P)		
5	Fitimi ushtrimor i fundit të vitit	578(P)		
6	Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese	578(P)		
7	Diferenca rivlerësimi kreditore (pozitive)	574(P)		
8	Diferencat e konsolidimit kreditore (pozitive)			
9	Interesat pjesëmarrës të pakicës			
	Nëntotali A= (1+2+3+4+5+6+7+8+9)		A	
	II . Elementet përbërëse që zbriten (B) :			
1	Kapitali i nënshkruar i papaguar	5712		
2	Vlera nominale e aksioneve (të pashitura , të riblera)			
3	Humbjet e pashpërndara (të bartura)	577(-P)		
4	Humbja ushtrimore	578(-P)		

5	Diferenca rivlerësimi debitoare (negative)	574(-P)		
6	Aktive ¹ të qëndrueshme të patrupëzuara	531		
7	Diferencat e konsolidimit debitoare (negative)			
	Nëntotali B = (1+2+3+4+5+6+7)		B	
	Totali i kapitalit bazë C = (A-B)		C	
	KAPITALI SHITESË			
	III . Elementet përbërëse (J) :			
1	Rezervat e rivlerësimit	5732	EA	
2	Rezerva të përgjithshme		EB	
3	Istrumente hibride	56	EC	
4	Detyrime të varura me afat	56	F	
	Në qoftë se $F \leq C/2$ atëherë $G = F$		G	
	Në qoftë se $F > C/2$ atëherë $G = C/2$		G	
	Nëntotali i kufizuar H = (EA + EB + EC + G) :		H	
	Kufizimi i parë: në qoftë se $H \leq C$ atëherë J = H		J	
	Kufizimi i dytë: në qoftë se $H > C$ atëherë J = C		J	
	Totali i kapitalit shtesë para zbritjes (J)		J	
	IV . Elementet përbërëse që zbriten (P +Q+V) :			
1	Interesat pjesëmarrëse (P):			
--	Në shoqëritë jofinanciare të konsoliduara sipas metodës së kapitalit.		K	
--	Në shoqëritë financiare dhe jofinanciare të përjashtuara nga perimetri i konsolidimit.		L	
	Nëntotali P = (K+N)		P	
2	Garancitë e dhëna fondeve të garancive reciproke sipas kushteve të bankës qendrore.		Q	
3	Aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë (V) :			
--	rregullorja “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, miratuar me vendimin nr.13, datë 21.02.01 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;		V1	
--	rregullorja “Për madhësinë dhe plotësimin e kapitalit fillestar minimal për veprimtaritë e lejuara të bankave dhe të degëve të bankave të huaja të licencuara”, miratuar me vendimin nr.51, datë 22.04.99 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;		V2	
--	akte të tjera rregullative.		Vn	
	totali i akteve rregullative : V = (V1+V2+Vn)		V	

¹ sipas Manualit të Kontabilitetit Bankar duhet të zëvendësohet me fjalën “mjete”.

	Nëntotali i pjesës që zbritet është $(P+Q+V)$		$P+Q+V$	
	Llogaritja përmbledhëse e kapitalit bazë dhe e kapitalit shtesë pas zbritjes IV :			
1	Në qoftë se $J \leq (P+Q+V)$ atëherë :			
--	Kapitali shtesë pas zbritjes $JA = 0$		JA	
--	Kapitali bazë $CA = C + J - (P+Q+V)$		CA	
2	Në qoftë se $J > (P+Q)$ atëherë :			
--	Kapitali shtesë pas zbritjes $JA = J - (P+Q+V)$		JA	
--	Kapitali bazë $CA = C$		CA	
	Totali i kapitalit bazë dhe i kapitalit shtesë : $E = (JA+CA)$		E	

URDHËR
Nr. 13, datë 25.7.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.5/1, DATË 10.5.2004 TË INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM “PËR MIRATIMIN E FLETËS SË KONTROLLIT ARITMETIK DHE LOGJIK TË DEKLARATËS SË PASURISË DHE DETYRIMEVE FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 30 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr.5/1, datë 10.5.2004 të Inspektorit të Përgjithshëm, fleta e kontrollit aritmetik dhe logjik për deklaratën e pasurive dhe detyrimeve financiare, ndryshohet dhe zëvendësohet me modelin bashkëlidhur.

2. Ngarkohet Inspektorati Lartë i deklarimit dhe i kontrollit të pasurive, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Fatmira Laska

Flete kontrolli aritmetik dhe logjik

Nr indeksit Emri

Institucioni Funkzioni

Periudha

Asetet / (Detyrimet)

Nr	Pershkrimi	Shuma Progresive	Shtesa/Paksime <i>(per periudhen e dekl)</i>
I	Asetet		
II	Detyrimet		
III	Shuma e asetëve neto (aset - detyrim)		

Te ardhurat / Shpenzimet

Nr	Pershkrimi	Shuma
I	Te ardhurat	
II	Shpenzimet	
III	Te ardhurat neto (te ardhurat - shpenzimet)	

Shenime / Komente

Konkluzione

--

asnje veprim

kerkese per informacion

kontroll i plote

ka konflikt interesash

Date

--

Pergatiti

--

Autorizuesi

--

VENDIM

Nr. 33, datë 21.7.2005

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS NDËRMJET OST SHA DHE “DARFO ALBANIA” SHPK “PËR TRANSMETIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në bazë të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike“, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.539, datë 12.8.2004 “Për miratimin e modelit transitor të tregut të energjisë elektrike”, si dhe të vendimit nr.1, datë 25.1.2005 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike”, neni 10 pika 3, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, pasi shqyrtoi propozimin e OST sh.a. dhe “Darfo Albania” sh.p.k. për miratimin e kontratës për transmetimin e energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës ndërmjet OST sh.a. dhe “Darfo Albania” sh.p.k. “Për transmetimin e energjisë elektrike”, për periudhën deri më 31.12.2006.
(Bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Tarifa e shërbimit të transmetimit, e përcaktuar në pikën 4.3.a të kësaj kontrate, të jetë e vlefshme deri më 31.12.2005.
3. Ngarkohet OST sh.a. dhe “Darfo Albania” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema**

VENDIM
Nr. 34, datë 22.7.2005

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E IMPORTIT TË ENERGISË
ELEKTRIKE SHOQËRISË DARFO ALBANIA SHPK**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa dh; 15 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit”, neni 5 pika 1, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.7.2005, mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Darfo Albania” sh.p.k. për marrje të licencës për aktivitetin e importit të energjisë elektrike, vetëm për të plotësuar nevojat e furnizimit me energji elektrike të klientit të kualifikuar “Darfo Albania” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Dhënie e licencës për aktivitetin e importit të energjisë elektrike shoqërisë “Darfo Albania” sh.p.k., vetëm për të plotësuar nevojat e furnizimit me energji elektrike të klientit të kualifikuar “Darfo Albania” sh.p.k. për periudhën deri më 31.12.2006.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr. 35, datë 22.7.2005

**PËR DHËNIEN E LICENCËS SË FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR SHOQËRISË DARFO
ALBANIA SHPK, PËR FURNIZIMIN DHE TREGTIMIN E ENERGISË ELEKTRIKE PËR
KLIENTIN E KUALIFIKUAR DARFO ALBANIA SHPK**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa ç; 15 pika 1 dhe 45 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit”, neni 5 pika 1, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.7.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Darfo Albania” sh.p.k., për marrje të licencës së furnizuesit të kualifikuar për aktivitetin e furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, vetëm për plotësimin e nevojave të furnizimit me energji elektrike të klientit të kualifikuar “Darfo Albania” sh.p.k.

VENDOSI:

1. Dhënie e licencës së furnizuesit të kualifikuar shoqërisë “Darfo Albania” sh.p.k., për aktivitetin e furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, vetëm për plotësimin e nevojave të furnizimit me energji elektrike të klientit të kualifikuar “Darfo Albania” sh.p.k., për periudhën deri më 31.12.2006.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr. 36, datë 1.8.2005

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË KURUM ENERGY SHA
PËR LICENCËN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR
DHE IMPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13 pika 1 germat ç dhe dh, nenit 15 pika 1 dhe nenit 45 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11, bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.8.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë Kurum Energy sh.a. për licencën e furnizuesit të kualifikuar dhe të importit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Vazhdimin e mëtejshëm të procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Kurum Energy sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencave & Monitorimit dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore & Marrëdhënieve me Publikun për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

SHPALLJE KERKESË PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “Tokë bujqësore arë”, që preken nga Ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV Sukth-Sallmonë, Durrës.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është: KESH sh.a. Tiranë.

Me anën e këtij publikimi, kërkohet të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë së paluajtshme që shpronësohet dhe masën e kompensimit përkatës, të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, pranë Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15-ditëve pas publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT
TË NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT 110/20 KV
SUKTH-SALLMONE, DURRËS**

Rrethi: Durrës

Komuna: Xhafzotaj, Fshati Sallmone

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë bujqësore arë

Nr.	Emri	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr.pasuri së	Faqe	Sip. në m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e kompesimit në lekë
1.	Ibrahim	Muça	Tokë bujqësore	3255	87/71	105	400	1800	720.000
2.	Ibrahim	Peza	Tokë bujqësore	3255	87/82	120	106	1800	190.800
3.	Fadil	Vezi	Tokë bujqësore	3255	87/97	140	421	1800	757.800
4.	Fadil	Vezi	Tokë bujqësore	3255	87/74	115	220	1800	396.000
5.	Fiqiri	Domi	Tokë bujqësore	3255	87/91	124	530	1800	954.000
6.	Ibrahim	Peza	Tokë bujqësore	3255	87/94	127	695	1800	1.251.000
7.	Ibrahim	Peza	Tokë bujqësore	3255	87/83	121	625	1800	1.125.000
8.	Bektash	Driza	Tokë bujqësore	3255	87/88	107	625	1800	1.125.000
9.	Petrit	Memoçi	Tokë bujqësore	3255	87/86	112	425	1800	765.000
10.	Ferik	Vezi	Tokë bujqësore	3255	87/77	117	205	1800	369.000
	Totali						4.252		7.653.600

KËRKESE

Shtetësja Behixhe Elezi kërkon shpalljen të zhdukur të vëllait të saj, Demir Beduli, lindur më 2.1.1930 dhe banues në Aganas, Komuna Golem Kavajë.

**KËRKUESE
Behixhe Elezi**

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004

Doli nga shtypi më 9.8.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë